



ODPIS

GAZETA ZYRTARE

E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

Nr. 24

Prishtinë, 12 korrik 1985

VITI XL

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

DEKRET

PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI FORMIMIN E QENDRËS KRAHINORE PËR STËRVITJE TË KUADROVE PËR MBROJTJEN E PËRGJITHSHME POPULLORE

Shpallet Ligji mbi formimin e Qendrës Krahinore për Stërvitje të Kuadrove për Mbrojtjen e Përgjithshme Popullore, që e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar më 25 qershor 1985, në mbledhjen e Dhomës së Komunave më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike më 25 qershor 1985.

KK Numër 011-27/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

LIGJI

MBI FORMIMIN E QENDRËS KRAHINORE PËR STËRVITJE TË KUADROVE PËR MBROJTJEN E PËRGJITHSHME POPULLORE

Neni 1

Formohet Qendra Krahinore për Stërvitjet e Kuadrove për Mbrojtjen e Përgjithshme Popullore (në tekstin e mëtejshëm: Qendra).

Neni 2

Selia e Qendrës është në Hajvali.

Neni 3

Qendra ka vulën e vet të rumbullakët dhe vulën katrore. Përmbytja, forma dhe madhësia e vulës së rumbullakët dhe e vulës katrore përcaktohen me Statutin e Qendrës.

Neni 4

Veprimtaria e Qendrës është me interes të posaçëm shoqëror.

Neni 5

Qendra siguron kushtet për stërvitjen dhe aftësimin e eprorëve, komandave, shtabeve dhe njësisë të mbrojtjes territoriale dhe mbrojtjes civile dhe të

kuadrove të cilët kryejnë punët e mbrojtjes popullore në organet e administratës së mbrojtjes popullore të komunave, të kuadrove për MPP të organeve tjera të administratës të bashkësive shoqërore-politike të njësisë të lidhjeve të udhëheqjeve të bashkësive shoqërore-politike, të shërbimeve të vrojtimit dhe lajmërimit dhe të kriptombrojtjes; të kuadrove të cilët punojnë në punët e MPP në organizatat e punës së bashkuar, të organizatave shoqërore-politike, të bashkësive lokale, të organeve dhe organizatave tjera vetëqeverisëse; të mësimdhënësve të lëndës së mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe vetëmbrojtjes shoqërore të shkollave fillore dhe të mesme, të shkollave të larta dhe fakulteteve; si dhe zhvillon punë shkencore-kërkimore nga lëmi i mbrojtjes popullore dhe vetëmbrojtjes shoqërore.

Në Qendër mund të aftësohen dhe stërviten edhe kuadrot për nevojat e Armatës Popullore të Jugosllavisë.

Qendra organizon edhe forma të tjera të arsimit dhe stërvitjes për mbrojtjen e përgjithshme popullore dhe vetëmbrojtjen shoqërore për nevojat e komunës, të bashkësive lokale, për nevojat e organizatave të punës së bashkuar dhe për nevojat e organeve dhe organizatave tjera vetëqeverisëse.

Neni 6

Stërvitja e eprorëve, komandave dhe e shtabeve të mbrojtjes territoriale organizohet dhe zbatohet sipas dispozitave të cilat vlejnë për forcat e armatosura dhe në bazë të udhëzimit mbi kurset në forcat e armatosura të shtabit të përgjithshëm të Armatës Popullore të Jugosllavisë.

Stërvitja e kuadrove për mbrojtjen e përgjithshme popullore do të zhvillohet në frymën e bazave unike të planeve dhe programeve të stërvitjes për mbrojtjen e përgjithshme popullore.

Neni 7

Stërvitja në Qendër do të bëhet përmes kurseve dhe seminarëve të përhershme dhe të përkohshme dhe përmes formave tjera teorike dhe praktike të stërvitjes dhe të aftësimit.

Qendra mund të organizojë tubime shkencore dhe profesionale, si dhe këshillime nga lëmi i mbrojtjes së përgjithshme popullore.

Neni 8

Qendra ka Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme vetëqeverisëse.

Për dispozitat e Statutit të Qendrës me të cilat përcaktohet mënyra e realizimit të interesit të posaçëm shoqëror, pëlqimin e jep Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 9

Mbikëqyrjen e punës së Qendrës e bën Sekretariati Krahinor i Mbrojtjes Popullore për stërvitjen e kuadrove të mbrojtjes popullore dhe Shtabi Krahinor i Mbrojtjes Territoriale, për stërvitjen e kuadrove të mbrojtjes territoriale.

Nëse e kërkojnë interesat e posaçme të mbrojtjes popullore, Qendra është e detyruar të veprëjë sipas urdhërësive të Sekretariatit Krahinor të Mbrojtjes Popullore dhe të komandantit të mbrojtjes territoriale të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, derisa për këtë ekziston nevoja.

Neni 10

Qendra ka programin vjetor dhe afatmesëm të stërvitjes së kuadrove, si dhe planin e zhvillimit.

Programet nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen sipas kapaciteteve dhe nevojave për stërvitjen e kuadrove, dinamikës sipas llojeve dhe formave të stërvitjes së personave nga neni 5 i këtij ligji.

Për programet nga paragrafi 1 i këtij neni, përqimin e jep sekretari krahinor i mbrojtjes popullore dhe komandanti i mbrojtjes territoriale të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 11

Qendra mban evidencën e nevojshme për stërvitjen, kujdeset për mirëmbajtjen teknike të objektit, lokaleve dhe poligonit.

Personave të cilët e kryejnë stërvitjen, Qendra u jep vërtetime për kursin ose seminarin e kryer, përkatësisht për stërvitshmërinë për kryerjen e detyrave të caktuara të mbrojtjes popullore.

Neni 12

Për kryerjen e punëve dhe detyrave të përcaktuara me këtë ligj dhe statut, Qendra përcakton organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e detyrave dhe punëve.

Për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, Qendra kohë pas kohë mund të angazhojë punëtorë profesionalë nga Shtabi Krahinor i Mbrojtjes Territoriale, nga Sekretariati Krahinor i Mbrojtjes Popullore, si dhe bashkëpunëtorë tjerë të jashtëm sipas nevojës.

Neni 13

Në kryerjen e punëve nga fushëveprimtaria e vet, Qendra bashkëpunon me bashkësitë shoqërore-politike, me organizatat shoqërore-politike, me universitetet, me fakultetet dhe degët e mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe vetëmbrojtjes shoqërore, me qendrat për stërvitje të republikave socialiste, me Krahinën Socialiste Autonome të Vojvodinës, si dhe me Armatën Popullore të Jugosllavisë; me organizatat e punës së bashkuar, bashkësitë lokale, me organizatat dhe institucionet shkencore-kërkimore, me organet e administratës, si dhe me organet e organizatave tjera.

Neni 14

Mjetet për stërvitje dhe aftësim të kuadrove sipas këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kuadër të mjeteve të Sekretariatit Krahinor të Mbrojtjes Popullore.

Neni 15

Organizatat themelore dhe organizatat tjera të punës së bashkuar dhe organizatat e bashkësitë tjera vetëqeverisëse, si dhe komunat, i sigurojnë mjetet në emër të kompensimit për vendosje, ushqim dhe në emër të mjeteve mësimore për stërvitjen e kuadrove të veta.

Lartësinë e kompensimit e përcakton Qendra.

Neni 16

Qendrën e udhëheq kryeshefi i Qendrës.

Kryeshefin e emëron Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me propozimin e sekretarit krahinor të mbrojtjes popullore dhe komandantit të Shtabit Krahinor të Mbrojtjes Territoriale.

Për punën e vet kryeshefi i përgjegjet Pleqësisë së Qendrës dhe Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 17

Kryeshefi i Qendrës e përfaqëson dhe e paraqet Qendrën dhe i nënshkruan aktet e Qendrës, në kuadër të të drejtave dhe detyrave të përcaktuara me Statutin e Qendrës.

Neni 18

Kryeshefi i Qendrës:

— drejtpërdrejt organizon punën dhe udhëheq me punën e Qendrës, si dhe është përgjegjës për punën ligjore të Qendrës,

— nxjerr planin dhe programin e punës të Qendrës,

— përcakton planin dhe orarin e shfrytëzimit të lokaleve për mësim, si dhe shfrytëzimin e objekteve dhe mjeteve të tjera në pajtim me planin e Qendrës,

— kujdeset për organizimin dhe sigurimin e realizimit të mësimin në Qendër dhe merr masa për përparimin e organizimit të punës dhe metodikës së stërvitjes, si dhe për zhvillimin me plan të bazës materiale të stërvitjes,

— kujdeset për sigurimin e kushteve për jetë dhe punë të personave që janë për stërvitje në Qendër,

— përcakton kohën e punës dhe rendin e brendshëm në Qendër dhe kujdeset për aplikimin e dispozitave mbi punën e Qendrës,

— përgatit dhe kujdeset për sigurimin e materialit për mbledhjet e Pleqësisë,

— paraqet raportin vjetor mbi punën e Qendrës dhe mbi mjetet e shfrytëzuara të siguruar për punë dhe për zhvillim të Qendrës, si dhe udhëheqjen e evidencës mbi afarizmin material dhe financiar të Qendrës,

— kujdeset për masat e sigurisë dhe të vetëmbrojtjes shoqërore në Qendër dhe

— kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statutin e Qendrës dhe me akte e tjera të përgjithshme.

Neni 19

Për punë në Qendër mund të pranohet punëtori i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara me Ligjin mbi marrëdhëniet e punës dhe Rregulloren mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të Qendrës.

Plotësimi i vendeve të punës bëhet përmes konkursit të Qendrës ndërsa zgjedhjen e punëtorëve e bën Pleqësia e Qendrës, në pajtim me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës.

Neni 20

Organi qeverisës i Qendrës është Pleqësia e Qendrës (në tekstin e mëtejshëm: Pleqësia).

Pleqësia e Qendrës ka 15 anëtarë në të cilën nga një anëtar e delegojnë Sekretariati Krahinor i Mbrojtjes Popullore, Shtabi Krahinor i Mbrojtjes Territoriale, Komiteti Krahinor për Arsime, Shkencë dhe Kulturë, Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, Konferenca Krahinore e Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës, Këshilli Krahinor i Lidhjes së Sindikatave të Kosovës, Konferenca Krahinore e Lidhjes së Rinisë Socialiste të Kosovës, Konferenca Krahinore e Lidhjes së Eprorëve Ushtarakë Rezervë, Këshilli Krahinor i Lidhjes së Shoqa-

tave të Luftëtarëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Armata Popullore e Jugosllavisë. Pesë anëtarë të tjerë i delegojnë këshillat ekzekutive të kuvendeve komunale.

Anëtarët e Pleqësisë emërohen në afat prej katër vitesh, e mund të revokohen para kalimit të kësaj kohe.

Pleqësia zgjedh kryetarin e Pleqësisë nga radhët e anëtarëve të vet.

Neni 21

Pleqësia:

— nxjerr Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Qendrës,

— shqyrton dhe nxjerr planin dhe programin e punës,

— planifikon zhvillimin e Qendrës,

— shqyrton raportin mbi punën, afarizmin materialo-financiar dhe çështjet e tjera me rëndësi për punën e Qendrës,

— shqyrton çështjet e organizimit dhe të zbatimit të stërvitjes dhe aftësimit,

— kryen funksionin e Pleqësisë botuese të Qendrës dhe

— kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj, Statutin dhe me aktet e tjera të përgjithshme.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, jap

DEKRET

PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI ELEKTROEKONOMINË

Shpallet Ligji mbi elektroekonominë, që e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, më 25 qershor 1985.

KK Numër 011-25/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

LIGJI

MBI ELEKTROEKONOMINË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet për ushtrimin e veprimtarisë elektroekonomike, funksionimin e sistemit elektroenergjetik, kushtet e përgjithshme për dërgimin e energjisë elektrike, kycjen e objekteve elektroenergjetike të konsumuesve në rrjetin elektroenergjetik, dërgimin e energjisë elektrike, themelimin e bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për veprimtarinë elektroekonomike.

Neni 2

Veprimtaritë elektroekonomike janë prodhimi, bartja dhe distribuimi i energjisë elektrike.

Organizatata e punës së bashkuar të cilat merren me prodhimin, bartjen dhe distribuimin e energjisë

elektrike për nevojat e konsumuesve, konsiderohen, në pajtim me këtë ligj, organizata elektroekonomike (në tekstin e mëtejshëm: organizatat elektroekonomike).

Neni 3

Prodhim i energjisë elektrike në pajtim me këtë ligj konsiderohet prodhimi i energjisë elektrike në organizatat e punës së bashkuar (në hidrocentrale, termocentrale dhe në centrale elektrike të tjera) dhe të cilat janë të kyçura në rrjetin e bartjes ose të distribuimit.

Bartja e energjisë elektrike konsiderohet, në kuptim të këtij ligji, bartja e energjisë elektrike nga elektranat të cilat janë kyçur në rrjetin e bartjes deri te objektet distributive elektroenergjetike dhe se konsumuesit drejtpërdrejtë të kyçur në rrjetin e bartjes, si edhe bartja e energjisë elektrike për këmbim dhe nevoja transite të sistemeve tjera elektroenergjetike.

Me distribuim të energjisë elektrike kuptojmë në vështrim të këtij ligji, transformimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike nga rrjeti transmetues si dhe dërgimin e energjisë konsumatorëve që janë të kyçur në rrjetin distribues.

Konsumues të energjisë elektrike në pajtim, me këtë ligj, konsiderohen të gjithë shfirtëzuesit e energjisë elektrike.

Neni 4

Prodhimin e energjisë elektrike mund ta bëjë edhe organizata tjetër e punës së bashkuar edhe prodhuesit individualë (në tekstin e mëtejshëm: organizatat).

Objektet elektroenergjetike, stabilimentet dhe instalimet e organizatave nga paragrafi 1 të këtij neni duhet t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike dhe kushtet të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë, si dhe kushtet për ruajtjen e ambientit të njeriut.

Organizatata nga paragrafi 1 të këtij neni mund t'u dërgojnë energji elektrike organizatave elektroekonomike për dërgimin respektivisht distribuimin, si dhe organizatave tjera të punës së bashkuar, konsumuesve, në qoftë se objektet elektroenergjetike të këtyre konsumuesve drejtpërdrejt janë të kyçur në objektet elektroenergjetike të dërguesit.

Marrëdhëniet reciproke në pikëpamje të dërgimit të energjisë elektrike ndërmjet organizatave nga paragrafi 3 të këtij neni, përcaktohen me marrëveshje vetëqeverisëse, përkatësisht me kontratë që lidhet më së voni gjer në afatin e miratimit të bilancit elektroenergjetik.

Nëse në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni nuk lidhet marrëveshja vetëqeverisëse respektivisht kontrata, marrëdhëniet reciproke zgjidhen në kuadër të BVI të elektroekonomisë.

Neni 5

Objektet dhe stabilimentet elektroenergjetike për prodhimin, bartjen dhe distribuimin e energjisë elektrike e përbëjnë sistemin unik elektroenergjetik të Kosovës.

Uniteti teknik i sistemit elektroenergjetik të Kosovës realizohet me lidhmërinë reciproke të objekteve dhe të stabilimenteve elektroenergjetike prodhuese, të bartjes dhe distribuimit, nëpërmjet largpërcuesve.

Uniteti teknologjik i sistemit elektroenergjetik të Kosovës realizohet nëpërmjet punës paralele të elektranave të këmbimit optimal të prodhimit të tyre me qeverisjen unike, me rregullimin automatik të shpërndarjes dhe të forcës e të shkëmbimit të energjisë elektrike, si dhe të sigurimit të nivelit të përcaktuar të tensioneve.

Neni 6

Sistemi elektroenergjetik i Kosovës lidhet me sistemet elektroenergjetike të Jugosllavisë, me qëllim të koordinimit të punës së prodhimitarise dhe me sistemet e kapaciteteve bartëse elektroenergjetike të republikave dhe të krahinave për furnizim më të mirë dhe më të sigurtë të konsumatorëve me energji elektrike.

Neni 7

Organizatave elektroekonomike kanë për detyrë që të harmonizojnë organizimin e vet dhe marrëdhëniet reciproke, me qëllim të sigurimit të unitetit të sistemit elektroenergjetike të Kosovës dhe për përmbushjen e interesave të përbashkëta dhe të nevojave të konsumuesve të energjisë elektrike dhe të organizatave elektroekonomike.

Neni 8

Organet elektroekonomike dhe konsumuesit e energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave dhe të interesave të përbashkët, harmonizimin e marrëdhënieve reciproke të drejtave, të detyrimeve dhe të përgjegjësisë, harmonizimin e planeve dhe programeve të punës e të zhvillimit, të zgjerimit të bazës materiale, të punës, të shtimit të objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve e të stabilimenteve të reja elektroenergjetike bashkohen në bazë të marrëveshjes vetëqeverisëse në Bashkësinë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Bashkësia vetëqeverisëse e interesit), në të cilën, në mënyrë vetëqeverisëse, i rregullojnë marrëdhëniet reciproke.

Neni 9

Veprimtaria elektroekonomike të cilën e ushtrojnë organizatat elektroekonomike është punë me interes të veçantë shoqëror.

Interesi i veçantë shoqëror në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni realizohet edhe në afarizmin e organizatave të punës së bashkuar për prodhimin e thëngjillit (shfrytëzimin në galeri dhe sipërfaqësor), me të cilin sigurohet prodhimi i përhershëm i thëngjillit për nevojat e elektranave (në tekstin e mëtejme: organizatat të cilat përherë prodhojnë thëngjill për nevojat e elektranave).

Neni 10

Marrëdhëniet reciproke të organizatave elektroekonomike dhe të organizatave të cilat përherë prodhojnë thëngjill për nevojat e elektranave në pikëpamje të prodhimit, të bartjes, të distribuimit të energjisë elektrike dhe të prodhimit të thëngjillit për nevojat e elektranave dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre organizatave dhe prodhuesve të energjisë elektrike, mbështeten në bazat vetëqeverisëse dhe rregullohen me marrëveshje vetëqeverisëse dhe me akte tjera të përgjithshme vetëqeverisëse drejtpërdrejt, si dhe në kuadër të bashkësisë vetëqeverisëse të interesit.

Neni 11

Pëlqimin në marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bashkimin në organizatën punonjëse të elektroekonomisë e jep kuvendi i komunës në territorin e së cilës është selia e organizatës punonjëse të elektroekonomisë me mendimin paraprak të marrë të kuvendit të komunës në territorin e së cilës gjendet selia e organizatave themelore të punës së bashkuar të elektroekonomisë të cilat bashkohen.

Pëlqimin me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bashkimin në organizatën e përbërë të elektroekonomisë e jep Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

II. TË USHTRUARIT E VEPRIMTARISË ELEKTROEKONOMIKE

Neni 12

Marrëdhëniet ndërmjet organizatave elektroekonomike, si dërguese të energjisë elektrike dhe të konsumuesve të energjisë elektrike rregullohen në pajtim me kushtet e përgjithshme për dërgimin e energjisë elektrike, sistemin tarifor, qëndrimet tarifore për dërgimin e energjisë elektrike dhe me aktet e tjera të përgjithshme të bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë, e në pajtim me këtë ligj.

Neni 13

Organizatave të punës së bashkuar mund ta ushtrojnë veprimtarinë elektroekonomike në qoftë se objektet elektroenergjetike dhe stabilimentet për prodhimin, bartjen ose distribuimin e energjisë elektrike i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike dhe kushtet e tjera dhe në qoftë se kanë në marrëdhënie pune punëtorë me përgatitje përkatëse profesionale për kryerjen e punëve dhe të detyrave të caktuara sipas natyrës së veprimtarisë teknologjike dhe kushtet e tjera të përcaktuara me akte të përgjithshme vetëqeverisëse.

Neni 14

Objektet dhe stabilimentet elektroenergjetike të organizatave elektroekonomike duhet t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike dhe kushtet e tjera elektroenergjetike, kushtet të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë, kushtet për ruajtjen e ambientit të njeriut, si dhe kushtet në pikëpamje të mbartjes së përgjithshme popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore.

Kushtet teknike dhe kushtet e tjera elektroenergjetike nga paragrafi 1 të këtij neni i përfshijnë masat dhe normativat teknike lidhur me projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e objekteve dhe të stabilimenteve elektroenergjetike, si dhe me dërgimin e energjisë elektrike.

Organi krahinor i administratës kompetent për punët e elektroekonomisë i përcakton kushtet nga paragrafi 2 të këtij neni, në qoftë se këto kushte nuk janë përcaktuar me dispozitat e tjera.

1. Kushtet e përgjithshme për dërgimin e energjisë elektrike, sistemin tarifor dhe qëndrimet tarifore

Neni 15

Me kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike rregullohen kushtet dhe mënyra e kycjes së objekteve elektroenergjetike të konsumuesve të rinj dhe shtimi i konsumit të energjisë elektrike, përkatësisht fuqisë së angazhuar të konsumuesve ekzistuesi dhe kushtet e mënyra e dërgimit të energjisë elektrike konsumuesve, e posaçërisht:

1. kushtet dhe mënyra e dhënies së pëlqimit elektroenergjetik për kycjen e objekteve elektroenergjetike të konsumuesve të rinj të energjisë elektrike dhe dhënien e pëlqimit për shtimin e konsumit të energjisë elektrike, përkatësisht të fuqisë së angazhuar tek konsumuesit ekzistues,

2. kushtet dhe kriteret më të hollësishme për të cilat shtimi i konsumit të energjisë elektrike, përkatësisht fuqia e angazhuar te konsumuesit ekzistues nuk nevojitet pëlqimi elektroenergjetik,

3. kushtet sipas të cilave objektet elektroenergjetike të konsumuesve të rinj të energjisë elektrike kycen në rrjetin e përçarjes ose të distribuimit,

4. kushtet, mënyra dhe afatet e lidhjes së kontratave për dërgimin e energjisë elektrike, vendi i dorëzimit dhe i matjes së energjisë elektrike, detyrat e dërguesit mbi furnizimin e kontinuuar të kon-

sumuesve me energji cilësore elektrike dhe obligimet e konsumuesve lidhur me dërgimin e energjisë elektrike,

5. mënyra e llogaritjes dhe e pagesës së energjisë elektrike, lëshimet, bonifikimet, si dhe shuma e dënimit sipas kontratës në rast të dërgimit jo me rregull dhe jo të rregullt të energjisë elektrike,

6. masat të cilat merren në raste të çrregullimeve afatshkurtëra (avarive) në sistemin elektroenergjetik, për pengimin e zgjerimit të mëtejshëm të avarive (shkatërrimi i sistemit elektroenergjetik të Krahinës),

7. kushtet dhe mënyra e ndërprerjes së dërgimit të energjisë elektrike konsumuesve,

8. kushtet dhe mënyra e konsumit racional dhe e kursimit të energjisë elektrike,

9. kushtet dhe mënyra e dërgimit të energjisë elektrike në rast mungese të përgjithshme të energjisë elektrike,

10. kushtet dhe kriteret më të hollësishme për caktimin e organizatave dhe të organeve të cilëve nuk mund t'u ndërprehet dërgimi i energjisë elektrike në rast të mungesës së përgjithshme të energjisë elektrike dhe në raste të tjera,

11. kushtet dhe mënyra e kyçjes së objekteve elektroenergjetike, të punishteve dhe të objekteve të përkohshme,

12. mënyra e informimit të konsumuesve për rastet nga pika 7, 8, 9 dhe 10 të këtij neni,

13. mënyra e konstatimit të harxhimit të paautorizuar të energjisë elektrike,

14. mbrojtja teknike e objekteve elektroenergjetike,

15. instalimet matëse dhe matja e energjisë së dërguar elektrike,

16. obligimet dhe përgjegjësitë e shërbimeve dispeçerike të organizatave elektroekonomike dhe të konsumatorëve, në zbatimin e urdhërave dhe të masave të Qendrës dispeçerike në nivelin e sistemit elektroenergjetik të Krahinës,

17. sistemi i lidhjeve dhe i punës kontinuele të sistemit elektroenergjetik të Krahinës.

Kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike shpallen në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

Neni 16

Me sistemin tarifor përcaktohen elementet tarifore themelore dhe qëndrimet tarifore për llogaritjen e energjisë elektrike, të cilat organizatat elektroekonomike ua dërgojnë konsumuesve të energjisë elektrike, si dhe mënyra e zbatimit të këtyre elementeve.

Me qëndrimet tarifore përcaktohen çmimet e energjisë elektrike sipas llojeve dhe kategorive të konsumuesve.

2. Kyçja e konsumuesve të rinj, përkatësisht shtimi i konsumit të konsumuesve ekzistues të energjisë elektrike

Neni 17

Për kyçjen e konsumuesve të rinj apo për shtimin e fuqisë së angazhuar, përkatësisht harxhimin e konsumuesve ekzistues të energjisë elektrike është i nevojshëm pëlqimi elektroenergjetik.

Nëse ndërtohet objekti i ri apo rikonstruktiohet objekti ekzistues i cili duhet të furnizohet me energji elektrike, përkatësisht për furnizimin e të cilit duhet shtuar fuqinë e angazhuar përkatësisht konsumin, pëlqimin nga alineja 1 të këtij neni duhet siguruar para dhënies së lejes ndërtimore.

Konsumuesi i energjisë elektrike mund të kërkojë dhënien e pëlqimit paraprak elektroenergjetik para hartimit të dokumentacionit teknik për ndërtimin e objektit të ri, përkatësisht rikonstrktimin e objektit ekzistues.

Pëlqimi elektroenergjetik dhe pëlqimi paraprak elektroenergjetik jepen në pajtim me kushtet e përgjithshme mbi dërgesën e energjisë elektrike.

Nëse këtë e kërkon konsumuesi i energjisë elektrike apo dhënësi i pëlqimit, pëlqimi elektroenergjetik nga alineja 1 e këtij neni jepet në kontratën mbi kyçjen e konsumuesit të ri, përkatësisht në kontratën mbi shtimin e fuqisë së angazhuar, përkatësisht të konsumit të konsumuesit ekzistues të energjisë elektrike.

Neni 18

Në qoftë se me dispozitat e këtij ligji nuk është caktuar ndryshe, pëlqimin elektroenergjetik, përkatësisht pëlqimin paraprak elektroenergjetik nga neni 15 i këtij ligji e jep organizata e përbërë e punës së bashkuar „Elektroekonomia e Kosovës”, në pajtim me aktet e përgjithshme vetëqeverisëse.

Organizata elektroekonomike ka për detyrë, në kufijtë e mundësive energjetiko-ekonomike dhe teknike, të jepë pëlqimin elektroenergjetik, nëse është paraparë shtimi i konsumit të energjisë elektrike në pajtim me planet dhe programet e zhvillimit të ndërtimit të objekteve elektroenergjetike dhe të stabiliteteve edhe pse me fuqinë e re apo fuqinë e shtuar të angazhuar, përkatësisht me konsumin esencialisht nuk rrezikohet lidhur me sasinë dhe cilësinë konsumi ekzistues i energjisë elektrike.

Neni 19

Kundër vendimit të pëlqimit elektroenergjetik, përkatësisht kundër pëlqimit paraprak elektroenergjetik apo refuzimit të këtij pëlqimi, mund t'i ushtrohet ankesë organit krahinor të administratës kompetent për punët e elektroekonomisë.

Neni 20

Objektet dhe stabilitetet elektroenergjetike të organizatave të elektroekonomisë dhe të prodhuesve tjerë të energjisë elektrike, si dhe stabilitetet, aparatet dhe instalimet elektroenergjetike dhe shpenzuesit e energjisë elektrike të konsumuesve, duhet t'i plotësojnë kushtet e konstatuara teknike, me të cilat bëhet siguria e njerëzve dhe e pasurisë dhe e sistemit elektroenergjetik.

Në qoftë se stabilitetet, pajisjet, instalimet elektroenergjetike dhe hargjuesit e konsumuesve nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike, mund të refuzohet përkohësisht kyçja e konsumuesve në rrjet dhe të caktohet afati brenda të cilit e ka për detyrë që t'i mënjanojë të metat e përcaktuara.

Në qoftë se inspektori elektroenergjetik konstaton se stabilitetet, pajisjet, instalimet dhe hargjuesit e konsumuesve i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike, kyçja e konsumuesve në rrjet duhet të bëhet.

3. Dërgimi i energjisë elektrike

Neni 21

Energjia elektrike iu dërgohet konsumuesve në bazë të kontratës.

Me kontratë nga paragrafi 1 i këtij neni mbëshet dhe rregullohet marrëdhënia në kohë të pacaktuar ose të caktuar (kontratat shumëvjeçare ose njëvjeçare).

Kontrata mbi dërgimin e energjisë elektrike duhet të lidhet në formë me shkrim, në pajtim me kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike.

Organizata elektroekonomike e cila merret me distribuimin e energjisë elektrike mundet, në pajtim me kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike konsumatorit t'i dërgojë energji elektrike edhe në bazë të kontratës mbi bashkimin.

Konsiderohet se kontrata mbi bashkimin është lidhur kur organizata elektroekonomike e cila merret me distribuimin e energjisë elektrike në bazë të kërkesës së paraqitur e kyç konsumuesin në rrjetin e vet.

Neni 22

Kontrata mbi dërgimin e energjisë elektrike përmban posaçërisht dispozitat mbi shumat energjetike (fuqia dhe energjia), mbi cilësinë e energjisë elektrike, mbi çmimin, përkatësisht paragrafin tarifor, mbi mënyrën dhe afatin e dërgimit, mbi vendin e dorëzimit dhe të masës mbi mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së energjisë elektrike të dërguar, mbi kohëzgjatjen e kontratës mbi përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar dhe shumën e dënimit me kontratë në rast të moskryerjes ose të kryerjes jo me rregull të obligimeve nga kontrata, si dhe dispozitat për atë se në cilat raste dhe në çfarë kushtesh duhet t'i çaset kursimit ose kufizimit të dërgimit të sasive të kontraktuara të energjisë elektrike, përkatësisht t'i ndryshojë cilësitë e kontraktuara të energjisë elektrike.

Neni 23

Kontrata mbi dërgimin e energjisë elektrike duhet të lidhet deri më 15 dhjetor të vitit vijues për periudhën e ardhshme të kontratës, përkatësisht më së voni 10 ditë para skadimit të vlerës së kontratës ekzistuese.

Deri në lidhjen e kontratës mbi dërgimin e energjisë elektrike, energjia elektrike dërgohet në pajtim me kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike, ndërsa energjia elektrike e dërguar llogaritet dhe paguhet në pajtim me sistemin tarifor dhe qëndrimet tarifore.

Kushtet e përgjithshme mbi dërgimin e energjisë elektrike zbatohen edhe në pikëpamje të marrëdhënieve të cilat nuk janë rregulluar me kontrata nga paragrafi 1 të këtij neni.

4. Bilanci elektroenergjetik

Neni 24

Bilanci elektroenergjetik cakton prodhimin e mundshëm të definuar kohor të burimeve të energjisë elektrike sipas strukturës, në bazë të kriterëve dhe të metodologjisë së përcaktuar me qëllim të përbushjes së nevojave të gjithmbarshme të konsumit të energjisë elektrike.

Neni 25

Propozimin e bilancit njëvjeçar elektroenergjetik e përcakton organizata e përbërë e punës së bashkuar „Elektroekonomia e Kosovës”, deri më 15 tetor të vitit vijues për vitin e ardhshëm.

Bashkësia vetëqeverisëse e interesit në bazë të propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni, i harmonizon dhe i nxjerrë bilancet njëvjeçare elektroenergjetike më së voni deri më 15 nëntor të vitit vijues për vitet e ardhshme.

Neni 26

Në qoftë se bashkësia vetëqeverisëse e interesit nuk e harmonizon dhe nuk e nxjerrë bilancin njëvjeçar elektroenergjetik të Kosovës brenda afatit të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji, atë do ta nxjerrë Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli Ekzekutiv).

5. Ndërprerja e dërgimit të energjisë elektrike

Neni 27

Organizatat elektroekonomike mund t'i ndërprejnë dërgimin e energjisë elektrike konsumuesit:

1. në qoftë se shpenzon energji elektrike pa pëlqimin elektroenergjetik ose kundër pëlqimit të dhënë, përkatësisht kundër kontratës mbi dërgimin e energjisë elektrike,

2. në qoftë se stabilimentet, aparatet, instalimet dhe shpenzuesit e tij nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike,

3. në qoftë se shpenzon energji elektrike pa aparate të matjes në kundërshtim me to ose në qoftë se këto aparate i paafëtson për punë normale,

4. në qoftë se pengon regjistrimin e rregullt të madhësive të llogaritura,

5. në qoftë se për kundër vërejtjes së dërguesit në afatin e caktuar në kontratë ngarkimin maksimal nuk e redukon në masën e kontraktuar,

6. në qoftë se nuk lejon ose pengon personat e autorizuar të dërguesit të energjisë elektrike që t'i kontrollojnë pajisjet matëse, përkatësisht stabilimentet, pajisjet, instalimet dhe hargjuesit elektrikë, për veç kur çasja stabilimenteve, pajisjeve, instalimeve dhe hargjuesve elektrikë është e ndaluar në bazë të ligjit,

7. në qoftë se në rast kursimi, përkatësisht kufizimi të konsumit të energjisë elektrike nuk i respekton dhe nuk i zbaton masat e përcaktuara.

Në rastet nga pika 2,4 dhe 6 paragrafi 1 të këtij neni, organizata elektroekonomike ka për detyrë që më parë t'ia tërheqë vërejtjen konsumuesit për të metat, përkatësisht parregullsitë për shkak të të cilave duhet t'ia ndërprejë dërgimin e energjisë elektrike dhe do të caktojë afatin e duhur për mënjanimin e këtyre të metave, përkatësisht të parregullsisë.

Përfundimisht nga dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, dërgimi i energjisë elektrike në rastin nga pika 2 alineja 1 të këtij neni mund të ndërprehet edhe pa vërejtje paraprake, në qoftë se ka të bëjë me parregullsin teknike e cila paraqet rrezik për jetën e njerëzve.

Neni 28

Në qoftë se konsumuesi të cilit i dërgohet energjia elektrike në bazë të kontratës nuk e paguan faturën për energjinë elektrike të dërguar brenda afateve të përcaktuara me kontratë, dërgimi i energjisë elektrike mund t'i ndërprehet në qoftë se nuk e paguan brenda afatit prej 15 ditësh prej ditës së dërgimit të vërejtjes me shkrim.

Në qoftë se konsumuesi të cilit i dërgohet energjia elektrike në bazë të kontratës mbi bashkimin nuk e paguan faturën brenda afatit të cilin e ka caktuar organizata elektroekonomike e cila e dërgon energjinë elektrike, dërgimi i energjisë elektrike mund t'i ndërprehet, në qoftë se faturën nuk e paguan as brenda afatit prej 15 ditësh prej ditës së dërgimit të vërejtjes me shkrim.

Në qoftë se energjia elektrike e dërguar paguhet me paradhënie mujore ose shumë mujore, ndërsa konsumuesit brenda afatit prej 15 ditësh pas ditës që është lajmëruar për paradhënien e konstatuar nuk ka paraqitur kundërshtim në shumën e saj, dërgimi i energjisë elektrike konsumuesit mund t'i ndërprehet në qoftë se paradhënien nuk e paguan as brenda afatit prej 15 ditësh pas skadimit të afatit në të cilin ka qenë i obliguar ta paguajë paradhënien.

Përfundimisht nga dispozitat e paragrafit 1 deri 3 të këtij neni nuk mund t'i ndërprehet dërgimi i energjisë elektrike për objektet, stabilimentet dhe aparatet, ndërprerja e punës e të cilave do të shkaktojë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Neni 29

Organizata elektroekonomike e cila e ndërprende dërgimin e energjisë elektrike kundër dispozitave të nenit 27 dhe 28 të këtij ligji, ka për detyrë që me shpenzime të veta përsëri të vazhdojë dërgimin brenda afatit sa më të shkurtër të mundshëm, e më së voni brenda afatit prej 24 orësh pasi që të konstatohet se dërgimi i energjisë elektrike është ndërprerë pa bazë.

Organizata e elektroekonomisë e cila e ka ndërprerë dërgimin e energjisë elektrike sipas dispozitave të nenit 27 dhe 28 të këtij ligji ka për detyrë pasi që konsumuesi t'i mënjanojë të metat ose parregullsitë e konstatuara, përkatësisht pasi që e ka paguar faturën për energjinë elektrike të dërguar, të vazhdojë dërgimin e energjisë elektrike me shpenzimet e konsumuesit brenda afatit prej tre ditësh.

Konsumuesit të cilit organizata elektroekonomike pa bazë ia ka ndërprerë dërgimin e energjisë elektrike ose nuk vazhdon që t'i dërgojë energji elektrike në pajtim me dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni ka të drejtë në kompensimin e dëmit i cili është shkaktuar nga kjo.

6. Kufizimi i dërgimit të energjisë elektrike

Neni 30

Në qoftë se për shkak të rrethanave të paparapara të prodhimit ose të sigurimit të energjisë elektrike zvogëlohet në atë masë sa që kjo e rrezikon furnizimin normal të konsumuesve në Kosovë (mungesa e përgjithshme e energjisë elektrike), dërgimi i energjisë elektrike do të kufizohet në tërë territorin e Kosovës, sipas kushteve dhe mënyrës së caktuar me këtë ligj.

Konsiderohet se është shkaktuar mungesë e përgjithshme e energjisë elektrike:

1. në qoftë se për shkak të rrethanave të shkaktuara në sistemin e elektroenergjetikës nevojat e gjithmbarshme të planifikuara të konsumit të energjisë elektrike duhet të zvogëlohet më së tepërmi për 10%, ose

2. në qoftë se, duke pasur parasysh gjendjen në akumulime dhe mundësitë objektive të furnizimit të termoelektraneve me karburante, parashikohet që në periudhën e ardhshme kohore për më së tepërmi prej 15 ditësh mund të shkaktohet zvogëlimi i prodhimit të energjisë elektrike për më tepër se 10%, në krahasim me prodhimin e gjithmbarshëm të planifikuar.

Neni 31

Me kushtet e përgjithshme mbi dërgesën e energjisë elektrike, në rast mungese të energjisë elektrike të caktohen masat dhe orari i dërgimit të kufizuar të energjisë elektrike, e sidomos:

1. kufizimi i ndërrimit të rrugëve, shesheve, objekteve, reklamave ndriçuese dhe të vitrinave deri në sigurimin e minimumit, ndalimin e përdorimit të nxemjes plotësuese dhe të ftohjes së lokaleve të punës, zvogëlimi i tensionit të rrjetit deri në nivelin më të ulët të lejueshëm,

2. kufizimi i dërgimit të energjisë elektrike konsumuesve specialë,

3. kufizimi i dërgimit të energjisë elektrike konsumuesve pa marrë parasysh nivelin e tensionit të marrjes të cilët shpenzojnë energji elektrike sipas procedurës elektroteknike ose elektrokimike.

Në qoftë se me masat nga pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1 të këtij neni nuk është e mundur të arrihet barazia e prodhimit me konsumin, aplikohet kufizimi i mëvonshëm i konsumit, si vijon:

— konsumuesve nga pika 2 paragrafi 1 të këtij neni,

— konsumuesve të tjerë pa marrë parasysh nivelin e tensionit deri 10%, përveç spitaleve, APJ, organeve të punëve të brendshme, organizatave ndësh-

kuese-korrektuese, organizatave edukative-korrektuese, sistemit të lidhjeve të komunikacionit, të radios e të televizionit.

Në qoftë se masat nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk mundësojnë harmonizimin e konsumit me prodhimin e mundshëm të energjisë elektrike, merren masat e mëtejshme të kufizimit, të cilat për çdo rast konkret do të caktohen veçmas.

Neni 32

Vendimin mbi mungesën e përgjithshme të energjisë elektrike, si dhe vendimin mbi masat e kufizimit nga neni 31 të këtij ligji e merr Kuvendi i Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë, me propozimin e organizatës së përbërë të punës së bashkuar të Elektroekonomisë së Kosovës.

Në qoftë se organizata nga paragrafi 1 i këtij neni nuk merr vendimin mbi mungesën e përgjithshme të energjisë elektrike dhe vendimin mbi masat e kufizimit, atëherë këtë do ta bëjë Këshilli Ekzekutiv.

Neni 33

Organizata elektroekonomike dhe konsumuesit e energjisë elektrike kanë për detyrë t'u përmbahen masave të kufizimit të dërgimeve, përkatësisht të konsumit të energjisë elektrike.

Neni 34

Organizatave elektroekonomike kanë për detyrë që përmjet mjeteve të informimit publik t'i informojnë konsumuesit me masat e kursimit, të kufizimit dhe të ndërprerjes së energjisë elektrike, me ndërprerjen e planifikuar të dërgimit të energjisë elektrike, për shkak të zhvillimit të punimeve në objektet elektroenergjetike dhe në stabilimente, si dhe me lëshuarjen në punë të stabilimenteve të posandërtuara nën tension më së voni brenda afatit prej 48 orësh para marrjes së këtyre masave, përkatësisht para fillimit të zhvillimit të punimeve dhe të lëshuarjes së stabilimenteve në punë.

III. NDËRTIMI DHE MIRËMBAJTJA E OBJEKTEVE ELEKTROENERGJETIKE

Neni 35

Për dhënien e lejes për ndërtimin e objekteve të rrjetit të bartjes dhe të distribuimit në qoftë se këto objekte nuk i ndërton organizata elektroekonomike, investuesi ka për detyrë të marrë pëlqimin për dokumentacionin investues teknik.

Pëlqimin nga paragrafi 1 i këtij neni e jep organizata punuese nga neni 18 i këtij ligji.

Neni 36

Organizata elektroekonomike ka për detyrë, që sipas kërkesës së investuesit, në mjetet e veta themelore t'i marrë stabilimentet e bartjes dhe të distribuimit të cilat shërbejnë për elektrifikimin e fshatrave, në qoftë se për to është dhënë pëlqimi nga neni 35 dhe pëlqimi për kyçjen e tyre.

Stabilimentet nga paragrafi 1 të këtij neni organizata elektroekonomike ka për detyrë që t'i marrë brenda afatit prej tre muajve prej ditës së paraqitjes së kërkesës.

Neni 37

Me qëllim të mirëmbajtjes së objekteve elektroenergjetike, të ndërtuara në pasurinë e paluajtshme e cila nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me rrugë publike, organizata elektroekonomike ka të drejtë të kalojë nëpër tokën e pronësisë shoqërore dhe nëpër tokën në të cilën ekziston e drejta e pronësisë.

Të drejtën e vet nga paragrafi 1 të këtij neni, organizata elektroekonomike e realizon në bazë të vendimit të cilin, sipas kërkesës së saj, e merr organi kompetent komunal i administratës.

Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, organizata elektroekonomike me qëllim të sigurimit të kushteve për furnizim të rregullt dhe të papenguar me energji elektrike në rastet e jashtëzakonshme mund ta shfrytëzojë të drejtën e kalimit deri te objektet elektroenergjetike dhe pa vendimin e organit kompetent komunal të administratës.

Organizatave elektroekonomike kanë për detyrë që pronarëve, përkatësisht shfrytëzuesve të tokave nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni t'ua kompensojë dëmin të cilin e ka shkaktuar duke kaluar nëpër këto toka.

Neni 38

Pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilët gjenden nën, mbi ose afër objekteve elektroenergjetike, rrjetin e bartjes ose të distributimit, nuk duhet t'i zhvillojnë punimet të cilat pengojnë bartjen ose distribuimin e energjisë elektrike pa pëlqimin e organizatës elektroekonomike.

Duke ndërtuar objekte ose duke zhvilluar punime në afërsi të objekteve dhe të stabilimenteve elektroenergjetike, nuk duhet penguar shfrytëzimin normal të këtyre objekteve dhe stabilimenteve.

Neni 39

Ndalohet mbjellja e fidaneve që rriten në tokën, mbi nën ose afër përcuesve dhe stabilimenteve elektroenergjetike, me të cilat mund të rrezikohet siguria e këtyre përcuesve, përkatësisht e stabilimenteve, të jetës së njerëzve dhe të pasurisë.

Organizata elektroenergjetike ka të drejtë që me qëllim të shfrytëzimit normal të objektit të ndërtuar elektroenergjetik të mirëmbajtjes në trase t'i krasitë ose mënjanojë drunjtë.

Neni 40

Në qoftë se me qëllim të mirëmbajtjes së objekteve të ndërtuara elektroenergjetike (të largpërcuesve, të trafostacioneve dhe të ngjashme) në tokën në të cilën është lejuar dhe është bërë prerja e plotë prerja e pyjeve, duhet bërë krasitjen ose prerjen e mëvonshme të fidaneve të rritura, të cilat rrezikojnë stabilimentet elektroenergjetike ose pengojnë shfrytëzimin normal të tyre, nuk është e nevojshme që të merret leja e re për prerje.

IV. BASHKIMI NË BASHKËSINË VETËQEVERISËSE TË INTERESIT TË ELEKTROEKONOMISË

Neni 41

Me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe të interesave të konsumuesve me energji elektrike dhe të organizatave elektroekonomike dhe për harmonizimin e punës në lëmin e elektroekonomisë me këto nevoja dhe interesa me këtë ligj përcaktohet detyra e themelimit të Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit në lëmin e elektroekonomisë.

Punët e Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë të caktuara me këtë ligj janë punë me interes të veçantë shoqëror.

Neni 42

Në Bashkësinë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë, bashkohen:

- organizatat elektroekonomike,
- organizatat e punës së bashkuar dhe organizatat dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse — konsumuesit e energjisë elektrike,

— qytetarët dhe personat civilo — juridikë të organizuar në bashkësitë lokale, konsumuesit e energjisë elektrike.

Neni 43

Bashkësia vetëqeverisëse e interesit e elektroekonomisë themelohet me marrëveshje vetëqeverisëse.

Me marrëveshje vetëqeverisëse rregullohet, në pajtim me ligjin, sidomos: mënyra e formimit të Kuvendit të bashkësisë së interesit, detyrat e bashkësisë, punët me interes të përbashkët, mënyra e vendosjes mbi këto punë, obligimet dhe përgjegjësitë e organeve dhe të shërbimeve të bashkësisë, organizata dhe fushëveprimi i kuvendit të bashkësisë dhe të organeve të tyre dhe të shërbimeve, si dhe çështjet e tjera me interes të përbashkët.

Neni 44

Për marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin e Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë pëlqimin e jep Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Neni 45

Në Bashkësinë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë, posaçërisht:

1. harmonizohen interesat e përbashkëta të organizatave elektroekonomike dhe të konsumuesve të energjisë elektrike,
2. harmonizohen interesat e përbashkëta të prodhuesve të thëngjillit dhe të organizatave elektroekonomike,
3. shiqohen bilanci elektroenergjetike afatmesme dhe afatgjata të nevojave me programin e zhvillimit dhe me mjetet bilancore,
4. caktohet sistemi tarifar dhe qëndrimet tarifore në pajtim me dispozitat mbi çmimet,
5. caktohen kushtet e përgjithshme mbi drëgimin e energjisë elektrike,
6. përcaktohet shuma e kompensimeve për kycjen e forcës së re dhe shtimin e forcës së kyçur të harxhuesve ekzistues,
7. kryhen edhe punë të tjera të cilat janë përcaktuar me marrëveshje vetëqeverisëse ose me Statutin e Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë.

Neni 46

Në vendimin e Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë nga pika 3 e nenit 45 të këtij ligji pëlqimin e jep Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e në vendimin nga pika 2, 4, 5 dhe 6 paragrafi 1 neni 45 të këtij ligji Këshilli Ekzekutiv.

Neni 47

Mënyra e financimit të Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë rregullohet me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi themelimin.

Neni 48

Puna e Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit të elektroekonomisë është publike.

Puna publike nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohet me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës në pajtim me ligjin.

V. MBIKËQYRJA

Neni 49

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bëjnë organet kompetente komunale dhe krahinore të administratës.

VI. DISPOZITAT NDESHKUESE

Neni 50

Me gjobë prej 50.000 deri 500.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik konsumuesi i energjisë elektrike — organizata e punës së bashkuar ose personi tjetër shoqëror-juridik:

1. në qoftë se kyç apo shton fuqinë e angazhuar, përkatësisht shpenzimin pa pëlqimin elektroenergjetik (neni 17 paragrafi 1),

2. në qoftë se objektet elektroenergjetike të tij, stabilimentet, aparatet, instalimet dhe shpenzuesit e energjisë elektrike nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike, me të cilat sigurohet siguria e njerëzve dhe e pasurisë dhe sistemi elektroenergjetik (neni 20 paragrafi 1),

3. në qoftë se shpenzohen energji elektrike në kundërshtim me pëlqimin e dhënë, përkatësisht në kundërshtim me kontratën mbi dërgimin e energjisë elektrike (neni 27 paragrafi 1 pika 1).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar, apo personi tjetër shoqëror-juridik me dënim me të holla prej 10.000 deri 50.000 dinarësh.

Neni 51

Me gjobë prej 50.000 deri 500.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata elektroekonomike:

1. në qoftëse pa bazë refuzon dhënien e pëlqimit elektroenergjetik, ose në qoftë se pëlqimi i dhënë nuk është në pajtim me programet e zhvillimit apo me planet e ndërtimit ose duke dhënë pëlqimin dukshëm e rrezikon konsumin ekzistues të energjisë elektrike (neni 18 paragrafi 2),

2. në qoftë se objektet e tij elektroenergjetike dhe stabilimentet nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike, me të cilat sigurohet siguria e njerëzve dhe e pasurisë dhe sistemi elektroenergjetik (neni 20 paragrafi 1),

3. në qoftë se nuk e kyç konsumuesit e energjisë elektrike kur inspektori elektroenergjetik konstaton se stabilimentet, instalimet dhe shpenzimet e konsumuesit i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike (neni 20 paragrafi 3),

4. në qoftë se nuk vërteton propozimin e bilancit të vet njëvjeçar elektroenergjetik në afatin e përcaktuar (neni 25),

5. në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 dhe 29 të këtij ligji i ndërprejnë konsumuesit dërgimin e energjisë elektrike, ose në qoftë se me shpenzimet e veta në afatin prej 24 orësh përsëri nuk vazhdon t'i dërgohet energji elektrike pasi që konstatohet se dërgimi është ndërprerë pa bazë (neni 29 paragrafi 1),

6. në qoftë se nuk vazhdon t'i dërgojë energji elektrike më së voni në afat prej 3 ditësh pasi që konsumuesi i ka mënjeluar të metat apo parregullsitë e konstatuara, përkatësisht pasi që ka paguar faturën për energjinë elektrike të dërguar dhe shpenzimet e kyçjes (neni 29 paragrafi 2).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën elektroekonomike në gjobë prej 3.000 deri 30.000 dinarë.

Neni 52

Me gjobë prej 50.000 deri 100.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje konsumuesi i energjisë — elektrike organizata e punës së bashkuar apo personi tjetër shoqëror-juridik:

1. në qoftë se shpenzon energji elektrike pa instalime matëse në kundërshtim me to apo nëse i bën të paafta për punë normale (neni 27 paragrafi 1 pika 3),

2. në qoftë se bën të pamundur regjistrimin normal të madhësive të llogaritura (neni 27 paragrafi 1 pika 4),

3. në qoftë se megjithë vërejtjen e dërguesit, brenda afatit të caktuar me kontratë ngarkimin maksimal nuk e redukton në masë të kontraktuar (neni 27 paragrafi 1 pika 5),

4. në qoftë se iu mohon të drejtën ose iu bën të pamundur personave të autorizuar dërgues të energjisë elektrike që t'i kontrollojnë aparatet e matjes, përkatësisht stabilimentet, aparatet dhe instalimet elektrike dhe shpenzuesit, përveç kur çasja stabilimenteve, paisjeve, instalimeve dhe hargjuesve elektrikë ndalohej në bazë të ligjit (neni 27 paragrafi 1 pika 6).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar apo personi tjetër shoqëror-juridik me gjobë prej 3.000 deri 50.000 dinarë.

Neni 53

Me gjobë prej 5.000 deri 100.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje konsumuesi i energjisë elektrike — qytetari:

1. në qoftë se kyçet ose e shton fuqinë e angazhuar, përkatësisht konsumin pa pëlqimin e elektroenergjetikës (neni 17 paragrafi 1),

2. në qoftë se stabilimentet, aparatet, instalimet dhe shpenzuesit e tij elektroenergjetikë të energjisë elektrike nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike (neni 20 paragrafi 1),

3. në qoftë se shpenzon energji elektrike pa aparate të matjes, në kundërshtim me to ose në qoftë se i bën të paafta për punë normale (neni 27 paragrafi 1 pika 3),

4. në qoftë se bën të pamundur regjistrimin normal të madhësive llogaritare (neni 27 paragrafi 1 pika 4),

5. në qoftë se nuk lejon ose pengon personat e autorizuar të dërguesit të energjisë elektrike që t'i kontrollojnë paisjet matëse, përkatësisht stabilimentet, paisjet, instalimet dhe hargjuesit, elektrikë, përveç kur çasja stabilimenteve, paisjeve, instalimeve dhe hargjuesve elektrikë ndalohej në bazë të ligjit (neni 27 paragrafi 1 pika 6),

6. në qoftë se mbjell fidane në tokë mbi ose nën përcuesit elektroenergjetikë ose stabilimente ose në qoftë se në tokën e vet nuk e lejon organizatën elektroekonomike që të bëjë krasitjen ose mënjanimin e fidaneve të cilat pengojnë shfrytëzimin normal të përcuesve, përkatësisht të stabilimenteve (neni 39).

Neni 54

Me gjobë prej 10.000 deri 50.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata elektroekonomike ose personi tjetër juridik në qoftë se nuk iu përmbahet masave të kufizimit të energjisë elektrike (neni 33).

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar ose personi tjetër juridik me gjobë prej 5.000 deri 10.000 dinarë.

Neni 55

Me gjobë prej 5.000 deri 10.000 dinarë do të dënohet për delikt ekonomik organizata elektroekonomike në qoftë se konsumuesit e energjisë elektrike nëpërmjet informimit publik nuk i njofton për rastet nga neni 34.

Për delikt ekonomik nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet personi përgjegjës në organizatën elektroekonomike me gjobë prej 1.000 deri 5.000 dinarë.

Neni 56

Me gjobë prej 5.000 deri 50.000 dinarë do të dënohet për kundërvajtje organizata e punës së bashkuar ose personi tjetër juridik:

1. në qoftë se në rastet urgjente të mirëmbajtjes së objekteve elektroenergjetike i pengon organizatën

elektroekonomike të drejtën e kalimit nëpër tokat e pronësisë shoqërore dhe në tokat me të cilat ekziston e drejta e pronësisë neni 37 paragrafi 3),

2. në qoftë se pa pëlqimin e organizatës elektroekonomike në pasurinë e paluajtshme e cila gjendet nën, mbi ose afër objekteve elektroenergjetike të rrjetit të përcuarjes ose të distribuimit zhvillon punimet të cilat pengojnë përcuarjen ose distribuimin e energjisë elektrike neni 38 paragrafi 1),

3. në qoftë se duke ndërtuar objektet ose duke zhvilluar punime në afërsi të objekteve ose të stabilimenteve elektroenergjetike pengon shfrytëzimin normal të këtyre objekteve dhe të stabilimenteve neni 38 paragrafi 2),

4. në qoftë se mbjell fidane në tokë mbi, nën ose afër objekteve të stabilimenteve elektroenergjetike, me të cilat mund të rrezikojë sigurinë e këtyre objekteve, përkatësisht të stabilimenteve, të jetës së njerëzve dhe të pasurisë neni 39 paragrafi 1).

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës në organizatën e punës së bashkuar ose në personin tjetër shoqëroro-juridik me gjobë prej 1.000 deri 5.000 dinarë.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 57

Bashkësia vetëqeverisëse e interesit e elektroekonomisë dhe organizatat elektroekonomike kanë për detyrë që afarizmin, punën dhe aktet e përgjithshme vetëqeverisëse t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji brenda afatit prej gjashtë muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 58

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji mbi elektroekonominë („Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”, nr. 32/76 dhe 9/82).

Neni 59

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

Në bazë të nenit 301 alineja 1 pika 22 dhe të nenit 319 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës,

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, të mbajtur më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR SHKARKIMIN E NJË ANËTARI TË KESHILLIT EKZEKUTIV TË KUVENDIT TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

I

Shkarkohet nga detyra e anëtarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës Remzi Kalgeci, për shkak të shkuarjes në detyrë të re.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Nr. 112-110/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Në bazë të nenit 301 alineja 1 pika 23 dhe të nenit 319 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës,

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave, të mbajtur më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR SHKARKIMIN E SEKRETARIT KRAHINOR TË MBROJTJES POPULLORE

I

Shkarkohet nga detyra e sekretarit krahinor të mbrojtjes popullore Remzi Kolgeci, për shkak të shkuarjes në detyrë të re.

II

Kë vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Nr. 112-111/85
Prishtinë 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 65 paragrafi 2 të Ligjit mbi gjykatat e rregullta („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 21/78, 49/79, 44/82, 44/84),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR ZGJEDHJEN E NJË GJYQTARI TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

I

Zgjedhet gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës Miftar Jasiqi, zëvendësprokuror publik i deritashëm i qarkut në Prishtinë.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-106/85
Prishtinë 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës shoqërore-Politike i Dhomës së Komunave
Nezir Prokshi, d.v. Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit mbi prokurorinë publike („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 32/76, 42/77, 49/79, 44/82 dhe 44/84),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PER EMERIMIN E ZEVENDESPROKURORIT PUBLIK KRAHINOR NË PRISHTINË

I

Emërohet zëvendësprokuror publik krahinor Mustafa Shala, kryetar i deritashëm i Kuvendit të Komunes të Podujevës.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-106/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Nezir Prokshi, d.v.

Kryetari
i Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 25 paragrafi 3 të Ligjit mbi prokurorinë publike („Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës”, nr. 32/76, 42/77, 49/79, 44/82 dhe 44/84),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PER SHKARKIMIN DHE EMERIMIN E ZEVENDESPROKURORIT PUBLIK TË QARKUT NË PRISHTINË

I

Shkarkohet nga detyra e zëvendësprokurorit publik të qarkut në Prishtinë Hamit Gashi, për shkak të shkuarjes në detyrë tjetër.

II

Emërohet zëvendësprokuror publik i qarkut në Prishtinë Ismet Kabashi, prokuror i deritashëm publik komunal në Mitrovicën e Titos.

III

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-119/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Nezir Prokshi, d.v.

Kryetari
i Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 77 paragrafi 1 dhe të nenit 65 paragrafi 2 të Ligjit mbi gjykatat e rregullta („Gazeta zyrtare e KSAK” nr. 21/78, 49/79, 44/82, 44/84),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PER SHKARKIMIN DHE EMERIMIN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË QARKUT NË GJILAN

I

Shkarkohet nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Rifat Zylfiu.

II

Emërohet kryetar i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan Refik Halilaj, gjyqtar i deritashëm i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan.

III

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-118/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Nezir Prokshi, d.v.

Kryetari
i Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 49 të Ligjit mbi administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 30/80 dhe 39/80),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore-Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PER EMERIMIN E ZEVENDESKRYETARIT TË KOMITETIT KRAHINOR TË ARSIMIT, TË SHKENCËS E TË KULTURËS

I

Emërohet zëvendëskryetar i Komitetit Krahinor të Arsimit, të Shkencës e të Kulturës Jordan Keciq, zëvendës drejtor i deritashëm i Entit Krahinor për Përparimin e Arsimit e të Edukimit në Prishtinë.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-102/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Nezir Prokshi, d.v.

Kryetari
i Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 301 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të nenit 29 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi avokatin shoqëror të vetëqeverisjes („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 44/82),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Komunave, më 25 qershor 1985 dhe në mbledhjen e Dhomës Shoqërore Politike, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR SHKARKIMIN DHE EMËRIMIN E ZËVENDËS-AVOKATIT KRAHINOR SHOQËROR TË VETËQEVERISJES

I

Shkarkohet nga detyra e zëvendësavokatit krahinor shoqëror të vetëqeverisjes Serbolub Tanasković, për shkak të shkuarjes në detyrë tjetër.

II

Emërohet zëvendës i avokatit krahinor shoqëror të vetëqeverisjes, Veselinka Avramović, sekretar i deritashëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

III

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-108/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Nezir Prokshi, d.v.

Kryetari
i Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Në bazë të nenit 23 paragrafi 1 pika 6 dhe të nenit 9 të Ligjit mbi zgjedhjen dhe revokimin e delegatëve të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 15/82),
Dhoma e Komunave të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR PUSHIMIN E MANDATIT TË DELEGATIT NË DHOMËN E KOMUNAVE TË KUVENDIT TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

I

I pushon mandati delegatit Smajl Dreshaj, delegat i Dhomës së Komunave të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, për shkak të inkompatibilitetit të funksionit.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-112/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i
Dhomës së Komunave
Shyqri Haziri, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Abaz Kazazi, d.v.

Në bazë të nenit 311 dhe 317 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të nenit 48 të Statutit të Muzeut të Kosovës dhe të nenit 60 të Ligjit mbi veprimtarinë muzeale dhe muze-të („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 37/77),

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, më 25 qershor 1985, mori

VENDIM

PËR DELEGIMIN E NJË ANËTARI NË TUBIMIN E PUNËTORËVE TË MUZEUT TË KOSOVËS NË PËRBËRJE TË GJERË

I

Delegohet anëtar në Tubimin e punëtorëve të Muzeut të Kosovës në përbërje të gjerë, Shani Hoxha, sekretar i deritashëm i Komisionit të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës për historinë e LK të Jugosllavisë.

II

Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës”.

KK Numër 112-105/85
Prishtinë, 25 qershor 1985

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Kryetari i
Dhomës së Punës së Bashkuar Kryetari i Kuvendit
Srebra Ivanović, d.v. Abaz Kazazi, d.v.

Në bazë të nenit 168 paragrafi 2 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale („Fletorja zyrtare e RS të Serbisë”, nr. 26/77), marr

A K T V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR LIRIMIN ME KUSHT

I. Në Komisionin për lirim me kusht të personave të gjykuar, të cilët dënimin me burgim e mbajnë në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale në territorin e KSA të Kosovës, emërohen:

1. Didare Dukagjini Gjorgjeviq, punëtorë shoqëro-politike nga Prishtina, anëtar,

— Tafil Hoxha, punëtor shoqëror-politik, nga Prishtina, zëvendës i anëtarit.

2. Dragomir Popović, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, anëtar,

— Halil Kelmendi, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës zëvendës i anëtarit.

3. Sahit Meraku, zëvendësprokuror publik Krahinor, anëtar,

— Nuo Selmani, zëvendësprokuror publik Krahinor, zëvendës anëtar.

4. Jusuf Karakushi, nënsekretar Krahinor i punëve të brendshme anëtar,

— Slobodan Mijović, kryeshef i kabinetit të Sekretariatit Krahinor të Punëve të brendshme, zëvendës i anëtarit.

5. Suad Černovërshanin, zëvendës i Sekretarit Krahinor të Judikaturës, anëtar,

— Mentor Qoku, ndihmëssekretar krahinor i judikaturës, zëvendës i anëtarit.

II. Kur Komisioni vendos për lirim me kusht të personave të cilët janë dënuar nga ana e Gjykatës Ushtarake, në punimet e Komisionit, me të drejtat dhe detyrat e anëtarit, merr pjesë Nenad Angjellković, kryetar i Gjykatës Ushtarake të Nishit.

III. Në secilën mbledhje të Komisionit në mënyrë alternative kryeson anëtar i tjetër i komisionit.

IV. Me këtë aktvendim ndryshohet Aktvendimi mbi formimin e Komisionit për lirim me kusht 03 nr. 701-858/82 datë 24. 06. 1982.

V. Ky aktvendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të KSA të Kosovës”.

03 Nr. 701-947/85
Prishtinë, 6 maj 1985

Sekretariati Krahinor i Judikaturës

Sekretari Krahinor
Prof. dr. Vesel Latifi, d.v.

V E N D I M

PER VLERËSIMIN E KUSHTETUTSHMERISE DHE TË LIGJSHMERISE TË RREGULLORES TË BASHKËSISE PUNUESE TË KOMITETIT KRAHINOR PËR MARRËDHËNIE ME BOTËN E JASHTME NË PRISHTINË, MBI DHËNIEN E BANESAVE NË SHFRYTËZIM DHE NDARJEN E KREDIVE PËR NDËRTIMIN INDIVIDUAL BANESOR

I. Gjykata Kushtetuese e Kosovës me iniciativë të vet, me Aktvendimin K numër 106/84 datë 27 shkurt 1985, ka filluar procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të nenit 8, të nenit 26 alineja 2 dhe të nenit 34 të Rregullores të Bashkësisë punuese të Komitetit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Prishtinë, mbi dhënien e banesave në shfrytëzim dhe ndarjen e kredisë për ndërtimin individual banesor, datë 18. X. 1985.

Bashkësia punonjëse e Komitetit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Prishtinë, nuk është përgjegjur në Aktvendimin e Gjykatës mbi fillimin e procedurës.

II. Duke vlerësuar Rregulloren e kontestuar, Gjykata gjatë procedurës dhe në seancë ka konstatuar: Punëtorët e Bashkësisë punonjëse të Komitetit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Prishtinë në referendumin e 18. X. 1984, e kanë nxjerrë Rregulloren mbi dhënien e banesave në shfrytëzim dhe ndarjen e kredisë për ndërtimin individual banesor.

Me nenin 8 të Rregullores është poentuar kontributi i punës së punëtorit varësisht nga „vendi i punës” së punëtorit dhe pikërisht për shfytëzimin dhe të këshilltarit (intern) 120 poena, për bashkëpunëtor të lartë profesional dhe bashkëpunëtor profesional 110 poena dhe për referent, sekretar teknik dhe daktilograf 100 poena.

Kontributi i punës së punëtorit, si njëri ndër kriteret për caktimin e rendit të përparësisë së punëtorit për ndarjen e banesave dhe të kredive banesore, përcaktohet varësisht nga ndërlikueshmëria e punëve, detyrat e kryera të punëve, cilësia dhe kushtet e punës, kursimet në punë, përgjegjësi të punëtorëve e të tjera, e duke u nisur nga kontributi i punës dhe rezultatet e arritura në punë por që e gjithë kjo, me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës duhet të objektvizohet, e jo si është paraparë në rastin konkret që për përcaktimin e kontributit të punës së punëtorit si kriter i vetëm të mirret vendi i punës, sepse kontributi i supozuar nuk do të thotë edhe kontribut real, respektivisht në kontributin e supozuar nuk mund të caktohen poenat. Andaj Gjykata ka konstatuar se dispozita e nenit 8 të Rregullores është në kundërshtim me ligjin.

Me nenin 26 alineja 2 të Rregullores është përcaktuar:

„Nëse kërkesa dhe dokumentet e punëtorit të interesuar për ndarjen e banesës ose të kredisë nuk janë të sakta, gjegjësisht nuk i përgjigjen gjendjes faktike, punëtori do të eliminohet nga ndarja e banesave meqë ka dhënë shënime jo të sakta”.

Gjykata ka konstatuar se kjo dispozitë është në mos pajtim me ligjin, nga shkak se punëtorët përjashtohen nga ndarja e banesave, si lloji i saksionit, për shkak të dhënies së shënimeve jo të sakta. Për veprime dhe sjellje të këtilla shqiptohen sanksione të cilat janë paraparë me ligj, përkatësisht me aktin gjegjës të përgjithshëm vetëqeverisës të organizatës themelore, respektivisht të bashkësisë punuese, në pajtim me ligjin.

Dispozita e nenit 34 të Rregullores është në mos pajtim me dispozitën e nenit 229 alineja 4 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe me nenin 151 paragrafi 4 të Ligjit mbi administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e KSAK”, numër 38/80), me të cilat parashikohet që aktet e përgjithshme vetëqeverisëse nuk mund të aplikohen para se të shpallen në mënyrë gjegjëse, e me dispozitën e nenit 34 të Rregullores është përcaktuar se i njëjti hyn në fuqi një ditë pas nxjerrjes.

Me dispozitat e Rregullores ku janë paraparë „organet dhe procedura mbi përgatitjen e ranglistës së përparësisë, si dhe organi për vendosje”, nuk janë caktuar organet të cilat vendosin në shkallën e parë dhe të dytë mbi dhënien e banesave në shfrytëzim, kështu që Gjykata ka konstatuar se Rregullorja në këtë pjesë është në mos pajtim me dispozitat e nenit 33 alineja 3 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore („Gazeta zyrtare e KSAK”, numër 11/83).

III. Në bazë të asaj që u tha, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 372 të Kushtetutës së KSA të Kosovës, në seancën e mbajtur më 30 prill 1985,

V E N D O S I

1. Anulohen dispozitat e nenit 8, të nenit 26 alineja 2 dhe të nenit 34 të Rregullores të Bashkësisë punuese të Komitetit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e jashtme në Prishtinë, mbi dhënien e banesave në shfrytëzim dhe ndarjen e kredive për ndërtimin individual banesor, datë 18. X. 1984.

2. Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

IV. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e mori këtë vendim në përbërje: kryetari i Gjykatës, Zeqir Marmullaku dhe gjyqtarët: Mehmed Dobraxhiq, Muharrem Ymeri, Radivoje Gillaviq, Miodrag Vërbica, Rifat Osmani dhe Metë Kuqi.

K numër 106/84
Prishtinë, 30 prill 1985

Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Kryetari
i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës
Zeqir Marmullaku, d.v.

V E N D I M

PER VLERËSIMIN E KUSHTETUTSHMERISE DHE TË LIGJSHMERISE SË UJDISË SHOQËRORE PËR REALIZIMIN E POLITIKËS KADROVIKE NË KSA TË KOSOVËS

I. Gjykata Kushtetuese e Kosovës në bazë të nenit 382 alineja 3 e Kushtetutës së KSA të Kosovës dhe të nenit 2 alineja 1 pika c) të Rregullores së punës të Gjykatës, me Aktvendimin K numër 7/84, datë 6 dhjetor 1984, filloi procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të nenit 4 alineja 1 fjalia e 2-të, në pjesën: „në organizatat e punës së bashkuar”, të nenit 14, të nenit 18 alineja 4 dhe të nenit 52 alineja 2 të Ujdisë shoqërore për realizimin e politikës kadroviqe të KSA të Kosovës („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 12/82).

Këshilli koordinues për realizimin e politikës kadrovike pran Konferencës Krahinore të LSPP të Kosovës, në bazë të bisedave të zhvilluara me nënshkruesit e Ujdisë, e ka informuar Gjykatën se pajtohen me pohimet nga Akatvendimi i Gjykatës për fillimin e procedurës dhe ndërmorën procedurën për ndryshime dhe plotësime të Ujdisë shoqërore.

II. Duke vlerësuar Ujdinë shoqërore, Gjykata gjatë procedurës dhe në seancë, konstatoi:

Ujdinë shoqërore mbi realizimin e politikës kadrovike në KSA të Kosovës e kanë lidhur Konferenca Krahinore e LSPP të Kosovës, Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Këshilli i Lidhjes së Sindikatave të Kosovës, Këshilli Krahinor i LSHL të LNÇ të Kosovës, Konferenca Krahinore e LRS të Kosovës, Kuvendi i KSA të Kosovës, Kryesia e KSA të Kosovës, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës dhe Oda Ekonomike e Kosovës.

Me nenin 4 alineja 1 fjalia e 2-të e Ujdisë shoqërore, është paraparë që nënshkruesit e Ujdisë në zbatimin e politikës së caktuar do të „sigurojnë përfaqësimin proporcional të kombeve dhe të kombësive në organet e organizatave shoqërore-politike, në organet e bashkësive shoqërore-politike, në organizatat e punës së bashkuar, në organizata dhe bashkësitë e tjera vetëqeverisëse“.

Me këtë dispozitë, përveç tjerash, rregullohet çështja e realizimit të politikës kadrovike me sigurimin e përfaqësimit proporcional të kombeve dhe të kombësive në zgjedhjen e kuadrove edhe në organizatat e punës së bashkuar.

Me kushtetutën e KSA të Kosovës, me dispozitën e nenit 177 alineja 3 është përcaktuar se çdo qytetari, në kushtet e barabarta, është aksesibil çdo vend pune dhe funksion në shoqëri.

Me Ligjin mbi punën e bashkuar, me dispozitën e nenit 167, është përcaktuar se secili mundet lirisht, në mënyrë të barabartë dhe në kushte të njëjta në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës, të lidhë marrëdhënien e punës me punëtorët e organizatës themelore.

Me dispozitat e nenit 119 të Kushtetutës të KSA të Kosovës është rregulluar mënyra e emërimit e organit individual-punëdrejtues, respektivisht të anëtarëve të organit kolegjial punëdrejtues në organizatat e punës së bashkuar.

Me ligjin mbi punën e bashkuar („Gazeta zyrtare e RSFJ“, numër 53/76), me dispozitat e nenit 504 deri 509, 538 dhe 539, si dhe me dispozitat e nenit 41 deri 54 të Ligjit mbi zgjedhjen e organeve të qeverisjes dhe të organeve të tjera në organizatat e punës së bashkuar („Gazeta zyrtare e KSAK“, numër 46/77), është përcaktuar mënyra dhe procedura lidhur me emërimin dhe shkarkimin e organit individual-punëdrejtues në organizatat e punës së bashkuar.

Me dispozitat e përmendura kushtetuese dhe ligjore është përcaktuar se organi individual-punëdrejtues, përkatësisht anëtarët e organit kolegjial punëdrejtues, në organizatat e punës së bashkuar, emërohen në bazë të konkursit të shpallur, me ç’rast çdo qytetari në kushte të barabarata i sigurohet pjesëmarrja në konkursin e shpallur.

Duke vlerësuar dispozitën e nenit 4 alineja 1 fjalia e 2-të e Ujdisë shoqërore, në raport me dispozitat e cekura të Kushtetutës dhe Ligjit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se e njëjta në pjesën „në organizatat e punës së bashkuar“, nuk është në pajtim me dispozitat e cekura të kushtetutës dhe të ligjit, për arsye se me aplikimin e dispozitës të tillë mund të cenohet parimi kushtetues sipas të cilit, në kushtet e barabarta, secili i është aksesibil çdo vend pune dhe funksion në shoqëri.

Me dispozitën e nenit 14 të Ujdisë shoqërore është rregulluar se pjesëmarrësit e Ujdisë, me rastin e zgjedhjeve për organet e organizatave politiko-shoqërore dhe të bashkësive politiko-shoqërore do të zbatojnë me konsekuencë dispozitat e Ujdisë, nga rrjedhëse me rastin e zgjedhjes do të aplikohen drejtpërdrejt dispozitat e kësaj Ujdie.

Nga dispozitat e nenit 18 alineja 4 të Ujdisë shoqërore me të cilin është përcaktuar se „organet dhe organizatat kompetente për zgjedhjen, respektivisht emërimin e funksionarëve kanë për detyrë që kërkesën për revokimin, ndërmimin apo shkarkimin nga detyra të funksionerit ta shqyrtojnë dhe në pajtim me ligjin dhe Ujdinë, të marrin vendimin e vet, si dhe për këtë të informohen pjesëmarrësit e Ujdisë“, rrjedhë se edhe në raport me këto çështje kjo Ujdi shoqërore drejtpërdrejt aplikohet.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjenë se dispozitat e nenit 14 dhe të nenit 18 alineja 4 e Ujdisë shoqërore nuk është në pajtim me dispozitat e Kushtetutës të KSA të Kosovës, të cilat kanë të bëjnë me Ujdinë shoqërore, si dhe me dispozitat e nenit 579 deri 585 të Ligjit mbi punën e bashkuar, sipas të cilave pjesëmarrësit e Ujdisë shoqërore me marrëveshje sigurojnë dhe harmonizojnë, përmes rregullimit vetëqeverisës, pos tjerash, çështjet dhe raportet me interes më të gjerë shoqëror për pjesëmarrësit e Ujdisë, apo me interes të përgjithshëm shoqëror dhe përcaktojnë politikën e përbashkët të cilën pastaj duhet ta realizojnë në aktet e veta të përgjithshme vetëqeverisëse.

Me nenin 52 alineja 2 të Ujdisë shoqërore është përcaktuar se „Ujdia hyn në fuqi një ditë pas ditës së nënshkrimit“. Lidhur me këtë Gjykata ka konstatuar se i njëjti nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 229 alineja 4 të Kushtetutës të KSA të Kosovës dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 577 të Ligjit mbi punën e bashkuar, me të cilin është përcaktuar se aktet e përgjithshme vetëqeverisëse nuk mund të aplikohen para se në mënyrën gjegjëse të shpallen, përkatësisht që aktet e përgjithshme vetëqeverisëse të shpallen para se të hyjnë në fuqi.

III. Në bazë të kësaj që u tha më lartë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 372 të Kushtetutës të KSA të Kosovës, në seancën e mbajtur më 14 qershor 1985,

V E N D O S I

1. Anulohen dispozitat e nenit 4 alineja 1 fjalia e 2-të në pjesën: „në organizatat e punës së bashkuar“, të nenit 14, të nenit 18 alineja 4 dhe të nenit 52 alineja 2 të Ujdisë shoqërore për realizimin e politikës të KSA të Kosovës („Gazeta zyrtare e KSAK“, numër 12/82).

2. Ky vendim të shpallet në „Gazetën zyrtare të KSAK“.

IV. Gjykata Kushtetuese e Kosovës këtë vendim e mori në përbërje: kryetari i Gjykatës Rifat Osmani dhe gjyqtarët: Radivoje Gllaviq, Muharrem Ymeri, Mehmed Dobraxhiq, Miodrag Vërbica, Zeqir Marmullaku dhe Metë Kuqi.

K numër 7/84

Prishtinë, 14 qershor 1985

Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Kryetari

i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës
Rifat Osmani, d.v.

Në bazë të nenit 11 dhe 24 të Ligjit mbi financimin e nevojave të përgjithshme shoqërore („Gaz. zyrtare e KSAK“, nr. 49/78) dhe nenit 243 të Statutit të komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e dhomave të Kuvendit, në fuqshëpërim të barabartë, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 1985

Neni 1

Të hyrat e përgjithshme që i përkasin komunës së Gjilanit për vitin 1985, sipas dispozitave të Ligjit

mbi financimin e nevojave të përgjithshme shoqërore, parashihen në shumë prej 370.131.300 dinarësh.

Neni 2

Buxheti i komunës së Gjilanit për vitin. 1985 është:

— të hyrat e përgjithshme	370,131.300 din.
— të radhitura	369,931.300 din.
— të hyrat e paradhitura-rezerva rrjedhëse buxhetore	200.000 din.

Neni 3

Nga të hyrat e përgjithshme të buxhetit që realizohen gjatë vitit, 1,5% ndahet në Fondin rezervë të komunës.

Neni 4

Të hyrat e mbetura pas shlyerjes së të dalave sipas llogarisë përfundimtare të buxhetit për vitin 1984, bartet në buxhetin e komunës për vitin 1985.

Neni 5

Mjetet për ushtrimin e veprimtarisë së rregullt të organeve të bashkësive shoqërore-politike, organeve komunale të administratës, organeve të judikaturës dhe organizatave që kryejnë punë me interes për Komunën, sigurohen me buxhet, ndërsa rradhitja e tyre sipas destinimeve bëhet me planin financiar.

Neni 6

Mjetet të cilat janë në pjesën e posaçme të buxhetit, të radhitura në fonde dhe destinime të tjera, barten dhe shfrytëzohen nëpërmes llogarive të veçanta të organeve.

Neni 7

Mjetet e radhitura në pjesën e veçantë të buxhetit për veprimtarinë e organizatave shoqërore-politike, barten në formë të dotacionit atyre organizatave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga buxheti.

Neni 8

Mjetet që u sigurohen organeve shoqërore-politike dhe bashkësive, organeve komunale të administratës, organeve të judikaturës dhe organizatave të cilat kryejnë punë me interes për Komunën, për pajisje dhe destinime të posaçme, mund të shfrytëzohen vetëm për nevojat për të cilat këto mjete janë siguruar, në bazë të parallogarisë të cilën e bie organi kompetent.

Mjetet e pashpenzuara nga paragrafi 1 të këtij neni, barten në vitin vijues për të njëjtat destinime.

Neni 9

Ndarjen e mjeteve që sigurohen për nevojat e bashkësive lokale e bënë Komisioni i posaçëm që e formon Dhoma e bashkësive lokale e KK Gjilan.

Neni 10

Organet komunale dhe shfrytëzuesit e tjerë të mjeteve buxhetore të Komunës janë të obliguar që kryerjen e detyrave nga fushëveprimi i punës së tyre ta organizojnë në kufijtë e mjeteve të lejuara buxhetore, duke u udhëhequr me parimin e racionalitetit dhe të kursimit me rastin e shfrytëzimit të mjeteve të lejuara.

Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 të këtij neni janë të obliguar që Sekretariatit për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta t'ia dërgojnë nga një ekzemplar të llogarisë periodike dhe të llogarisë përfundimtare, në afatin e caktuar ligjor, atëherë kur ia parashitrojnë SHKSH.

Neni 11

Organet komunale dhe shfrytëzuesit e tjerë të mjeteve nga buxheti i komunës, nuk mund të krijojnë obligime me të cilat do të ngarkonin buxhetin e komunës mbi shumën e përcaktuar për vitin 1985, ose të krijojnë obligime në llogari të buxhetit për vitin e ardhshëm, nëse obligimet e këtylla nuk janë përcaktuar me vendim të posaçëm në Kuvend të Komunës.

Neni 12

Bartjen e mjeteve të të gjithë shfrytëzuesve të mjeteve buxhetore në suazat e masës së radhitur të mjeteve sipas buxhetit për vitin 1985, do ta kryejë Sekretariati për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta në shumën të barabartë mujore.

Neni 13

Nëse të hyrat e buxhetit të komunës nuk realizohen në mënyrë të barabartë, Këshilli Ekzekutiv mund të kufizojë përkohësisht mjetet e radhitura në pjesën e veçantë të buxhetit për të gjitha destinimet ose destinimet e veçanta, përmes pezullimit të tyre ose shfrytëzimit të zvogëluar për periudhën e caktuar, proporcionalisht me mosrealizimin e të hyrave buxhetore.

Neni 14

Në rast të realizimit jo të barabartë të të ardhurave gjatë vitit, do të shfrytëzohet huaja nga Fondi rezervë sipas konkluzionit të Këshillit Ekzekutiv me afat të kthimit deri në fund të vitit buxhetor.

Urdhërdhënës për mjetet nga alineja e mëparshme është sekretari i Sekretariatit për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta.

Neni 15

Për pagesën e mjeteve buxhetore destinuar për veprimtari të rregullt, për pajisje dhe destinime të tjera, aplikohen dispozitat e Ligjit mbi administratën shtetërore.

Urdhërdhënës për pagesën e mjeteve të radhitura në pjesën e veçantë të buxhetit është eprori i organit në fushëveprimin e punës së të cilit bie zbatimin i detyrave të punës për të cilat janë destinuar mjetet.

Neni 16

Autorizohet Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës:

1. të disponojë dhe të bëjë radhitjen e mjeteve të paradhitura buxhetore (me rezervën rrjedhëse buxhetore), për qëllimet e caktuara deri në shumën prej 50.000 dinarësh;

2. të kryejnë radhitjen e mjeteve të paradhitura dhe mbi shumën e caktuar në pikën e mëparshme, por që mbi këtë t'i paraqes raport Kuvendit të Komunës në seancën vijuese.

Neni 17

Të hyrat që i realizojnë organet komunale të administratës, organet e judikaturës dhe organizatat që kryejnë punë me interes për Komunën, duke kryer shërbime për qytetarët, organizatave punuese dhe shfrytëzuesve të shërbimeve, orientohen në Buxhetin e komunës.

Nga paragrafi i përparshëm të këtij neni përjashtohen të hyrat e organeve të caktuara që këto mjete u janë lejuar këtyre organeve me vendim të posaçëm të komunës dhe orientohen në fondin për pajisje të këtyre organeve.

Neni 18

Autorizohet sekretari i Sekretariatit për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta të KK, që në emër të bashkësive shoqërore-politike të Gjilanit të nënshkruajë instrumentet e pagesës (çekun, kambialin me aval dhe garancionin).

Neni 19

Sekretariati për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta të KK Gjilan, drejt-përdrejt mund të bëjë kontrollin e mjeteve që me buxhetin e komunës për vitin 1985, u janë lejuar organeve komunale dhe shfrytëzuesve të tjerë, në emër të veprimtarisë së rregullt dhe për destinimet e posaçme, si dhe kontrollin mbi punën e tyre financiare e materiale.

Nëse me kontroll konstantohet se mjetet e parapara me buxhetin e komunës për vitin 1985 nuk shfrytëzohen në bazë të ligjit, racionalisht dhe sipas destinimeve, Sekretariati për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta do të njoftojë Këshillin Ekzekutiv me qëllim të marrjes së masave të nevojshme.

Neni 20

Të hyrat dhe të dalat e realizuara gjatë periudhës së financimit të përkohshëm, të cilat i kanë pasur sipas Vendimit mbi financimin e përkohshëm të nevojave dhe detyrave të komunës së Gjilanit, për periudhën janar-mars 1985 janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 21

Sqarimet dhe udhëzimet me të afërta për zbatimin e këtij vendimi, sipas nevojës, i jep Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës.

Neni 22

Radhitja e të hyrave të buxhetit të komunës në shumën prej 369.931.300 dinarësh, sipas pozicioneve, shfrytëzuesve dhe destinimeve të afërta në suazat e radhitjes së përgjithshme të të hyrave nga neni 2 të këtij vendimi, është bërë në pjesën e veçantë të buxhetit, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 23

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Sekretariati për administratën e përgjithshme, buxhet dhe punë të përbashkëta dhe Drejtorati për të ardhurat shoqërore të Kuvendit të Komunës.

Neni 24

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare e KSAK” dhe do të aplikohet prej 1 janar 1985.

01. Nr. 04/4/85

Gjilan, 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari
i Dhomës së
Bashkësive Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Zëvendëskryetari
i Dhomës Shoqërore-Politike
Enver Hyseni, d.v.

Kryetari i Dhomës së Punës së Bashkuar
Rabiye Hasani, d.v.

Në bazë të nenit 24 dhe 25 të Ligjit mbi financimin e nevojave të përgjithshme shoqërore („Gaz. zyrtare e KSAK” nr. 49/78) dhe të nenit 43 të Statutit të komunës së Gjilanit, „Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 43/75), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e të gjitha dhomave, në fushëveprim të barabartë, të mbajturë më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR APROVIMIN E LLOGARISË PËRFUNDIMTARE TË BUXHETIT TË KOMUNES SË GJILANIT PËR VITIN 1984

Neni 1

Të hyrat e realizuara dhe shpenzimet e bëra sipas Buxhetit të komunës së Gjilanit për vitin 1984 janë:

— Të hyrat e përgjithshme të realizuara	254,475.700 din.
Prej tyre:	
— shpenzimet e realizuara buxhetore	251,119.200 din.
— mjetet e ndara në Fondin rezervë	3.253.200 din.
— mjetet e paradhitura, gjendja në xhirollogari	133.300 din.

Neni 2

Mjetet e paradhitura nga neni 1 pika 4 në shumë prej 133.300 dinarësh, barten në Bilancin e të hyrave për vitin 1985.

Neni 3

Aprovohet Llogaria përfundimtare e Buxhetit të komunës të Gjilanit për vitin 1984, bashkë me pasqyrën e të hyrave të planifikuara, të realizuara dhe shpenzimet e realizuara në pjesën e veçantë të buxhetit dhe shtojcat e tjera të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

01. Nr. 417-2/85

Gjilan, 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Dhomës
së Bashkësisë Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabiye Hasani, d.v.

Zëvendëskryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Enver Hyseni, d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 2 të Rregullores për regjistrimin e tatimeve dhe të kontributeve të qytetarëve („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 19/80) dhe të nenit 253 të Statutit të komunës së Gjilanit („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 43/75), Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e të gjitha dhomave të Kuvendit, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR APROVIMIN E LLOGARISË PËRFUNDIMTARE TË TATIMEVE DHE TË KONTRIBUTEVE TË QYTETARËVE PËR VITIN 1984

Neni 1

Lejohet Llogaria përfundimtare e tatimeve të qytetarëve të komunës së Gjilanit për vitin 1984, me këtë gjendje:

— salldoja e borxhit sipas bilan- cit nga viti 1983	28,305.072,25
— ngarkimi sipas gjendjes së ta- timit të qytetarëve me regjis- trim për vit. 1984	49,319.190,50
GJITHSEJ NGARKIMI	77,624,262,75
— salldoja e parapagimit nga viti 1983	3,258.035,30
— janë inkasuar në vitin 1984	45.106.480,20
GJITHSEJT SHKARKIMI	48,364.515,50
— salldoja e borxhit më 31.12.1984	33,541.196,30
— salldoja e parapagimit më 31.12.1984	4.281.449,05

Neni 2

Në aspekt të inkasimit dhe të regjistrimit të ta-
timit, Drejtorati komunal i të ardhurave shoqërore
do të veprojë në tërësi sipas dispozitave të Ligjit për
caktimin dhe arkëtimin e tatimit dhe të Rregullo-
res për regjistrimin e tatimit të qytetarëve.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes
në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

01. Nr. 417-3/85
Gjilan, 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Dhomës
së Bashkësisë Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabije Hasani, d.v.

Zëvendës Kryetari i Dhomës
Shoqërore-Politike
Enver Hyseni, d.v.

Në bazë të nenit 13, 14, 15, 16, 17 dhe 19 të Ligjit
mbi qarkullimin e pasurisë së patundshme („Gaz. zy-
rtare e KSAK”, nr. 18/85) Kuvendi i Komunës së
Gjilanit, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bash-
kuar dhe të Dhomës së Bashkësive Lokale, në fushë-
veprim të barabartë, të mbajtur më 11 qershor 1985,
mori

V E N D I M

**PËR SHITJEN E LOKALEVE TË PUNËS, OBJEK-
TEVE BANESORE DHE TË TOKËS NDËRTIMORE
PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS
SË GJILANIT**

Neni 1

Me këtë vendim rregullohet mënyra e shitjes së
lokaleve të punës, objekteve banesore dhe tokës ndë-
rtimore pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, si
vijon:

1. Ngastra kadastrale nr. 3532 fleta poseduese nr.
1750 KK Gjilan, e regjistruar në emër të Kuvendit
të Komunës së Gjilanit, me kultur ndërtësë, me si-
përfaqe prej 0.01.26 ha dhe oborr në sipërfaqe prej
0.09.67 ha, e cila gjendet në rrugën „Rade Popović”
nr. 2.

2. Objekti në rrugën „Bllagoje Maksimović” i ci-
li shfrytëzohet nga ana e Sekretariatit për punët e
inspeksionit e evidentuar si ngastër kadastrale nr.
4670 me kultur ndërtësë në sipërfaqe prej 0.01.70 ha,
e regjistruar në fletën posedimit nr. 1750 në KK Gjil-
lan, në emër të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

3. Objekti në rrugën „S. Trajiq” ku gjindet shi-
torja e mobileve „Nash dom” evidentuar si ngastër
kadastrale nr. 3995 me fletëposeduese nr. 1750 KK
Gjilan, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.00.92 ha
pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

4. Objekti i cili gjendet në rr. „B. Kidriq” i shfry-
tëzuar si depo nga ana e organizatës punuese tregë-
tare „16 Nëntori” në Gjilan, e evidentuar si ngastër
kadastrale nr. 3671 në sipërfaqe prej 0.01.01 ha, e re-
gjistruar në fletën poseduese nr. 1750 KK Gjilan,
pronë e Kuvendit të Komunës.

5. Ngastra kadastrale nr. 4394/2, me kulturë shtë-
pie evidentuar në fletën poseduese nr. 1750 në KK
Gjilan, në sipërfaqe prej 0.00.32 ha, në emër të Ku-
vendit të Komunës së Gjilanit.

6. Ngastra kadastrale nr. 3062 me kultur shtëpi,
në sipërfaqe prej 0.01.42 ha dhe oborr në sipërfaqe
prej 0.00.80 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr.
1750 në KK Gjilan, pronë e Kuvendit të Komunës
së Gjilanit, në të cilin sipas planit detal urbanistik
parashifet ndërtimi individual.

7. Ngastra kadastrale nr. 3085 me kultur shtëpi,
në sipërfaqe prej 0.01.49 ha, e regjistruar në fletën
poseduese nr. 1750 në KK Gjilan, pronë e Kuvendit
të Komunës së Gjilanit, me të cilin në bazë të planit
detail urbanistik në një pjesë është paraparë vija e
komunikacionit, ndërsa në pjesën tjetër ndërtimi in-
dividual.

8. Toka ndërtimore e pandërtuar (ish lokacioni i
deponisë së qytetit) e cila evidentohet si ngastër ka-
dastrale nr. 2545 me kulturë arë e kl. I, në sipërfa-
qe prej 0.50.72 ha dhe prockë në sipërfaqe prej 0.05.
68 ha dhe ngastra kadastrale nr. 2544 me kulturë arë
e kl. I, në sipërfaqe prej 0.51.05 ha dhe prockë në
sipërfaqe prej 0.03.01 ha, të cilat evidentohen sipas
listës poseduese nr. 1750 pronë e Kuvendit të Komu-
nës së Gjilanit e të cilat gjenden në vendin e quaj-
tur „Livadhet e Arapit”.

Neni 2

Shitja e lokaleve të punës, objekteve banesore
dhe tokës ndërtimore të pandërtuar të cilat gjenden
në pronësinë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, të
përshkruara në nenin 1 të këtij vendimi do të bëhet
përmes licitacionit publik.

Neni 3

Autorizohet Këshilli Ekzekutiv i KK-së Gjilan, që
menjëherë pas aprovimit të këtij vendimi të formo-
jë Komisionin profesional i cili do të shpallë dhe do
të zbatojë procedurën e licitacionit publik.

Neni 4

Mjetet e fituara nga pasuria e patundshme e shi-
tur, Kuvendi i Komunës do t'i përdorë për
ndërtimin e objektivit për nevojat e organeve ko-
munale të administratës të Kuvendit të Komunës së
Gjilanit.

Neni 5

Kuvendi i Komunës së Gjilanit me akt të veça-
ntë do të autorizojë personin i cili do të nënshkrua-
jë kontratën mbi shitëblerjen e pasurisë nga neni 1
të këtij vendimi, me shfrytëzuesit e rinj — blerësit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes
në „Gazetën zyrtare të KSAK”, kurse do të apliko-
het nga dita e miratimit.

01. Nr. 361-3/85
Gjilan, 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Bashkësive Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabije Hasani, d.v.

Në bazë të nenit 6 të Ligjit mbi tatimet e qytetarëve („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 49/78) dhe të nenit 253 të Statutit të komunës së Gjilanit, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e të gjitha dhomave, në fushëveprim të barabartë, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA LLOGARITJA DHE PAGESA E TATIMIT NGA TË ARDHURAT PERSONALE TË PUNËTORËVE NË ORGANIZATAT E PUNËS SË BASHKUAR

Neni 1

Me këtë vendim organizatat e punës së bashkuar: Kombinati i tekstilit „Integj”, Fabrika e baterive të „Nikëll-kadiumit” Fabrika e radiatorëve „Jugoterm”, Organizata tregtare „16 Nëntori”, OBPB „Zhi-topromet”, OBPB „Gnjilanka”, përkohësisht lirohen nga llogaritja dhe pagesa e tatimit në të ardhurat personale të punëtorëve për periudhën prej 1 prill 1985 deri më 31 korrik 1985.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të KSAK”, ndërsa do të aplikohet prej 1 prill 1985.

01. Nr. 432-2/85
Gjilan 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Zëvendëskryetari i Dhomës
Shoqërore Politike
Enver Hyseni, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabije Hasani, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Bashkësive Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Në bazë të nenit 132 të Ligjit mbi marrëdhëniet e punës të KSAK („Gaz. zyrtare e KSAK” nr. 24/84) dhe të nenit 252 të Statutit të komunës së Gjilanit („Gaz. zyrtare e KSAK” nr. 43/75) Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën e Dhomës së Punës së Bashkuar dhe të Dhomës së Bashkësive Lokale, në fushëveprim të barabartë, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR PËRCAKTIMIN E VENDBANIMEVE NË TË CILAT MUND TË USHTROHET SHITJA E GAZETAVE NËPËRMES PUNËTORËVE TË PRANUAR NË PUNË ME KONTRATË PËR VITIN 1985

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen vendbanimet në territorin e komunës së Gjilanit, në të cilat mund të bëhet shitja e gazetave, librave dhe broshurave nëpërmes punëtorëve të pranuar në punën me kontratë nga OBPB gazetares-botuese.

Neni 2

Shitja e gazetave, librave dhe broshurave në mënyrën sipas nenit 1 të këtij vendimi, mund të bëhet në këto vendbanime: Përlepnice, Zhegër, Bresalc, Dobërçan, Cernicë, Pogragjë, Livoç i Poshtëm, Partesh, Malishevë, Pasjan e në qytet në Bashkësinë VII lokale (Çenar Çeshime), Bashkësinë lokale nr. III, Ba-

shkësinë lokale nr. V (Dheu i Bardhë) në afërsi të QSHM, në vendbanimin Gavran rruga e Prishtinës dhe tek kombinati i tekstilit „Integj”.

Neni 3

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij vendimi do ta bëjë Sekretariati për punë inspektuese të KK-së Gjilan.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

01. Nr. 650-1/85
Gjilan 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabije Hasani, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Bashkësive Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

Në bazë të nenit 158 të Ligjit mbi arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar („Gaz. zyrtare e KSAK” nr. 3/80) dhe të nenit 249 të Statutit të komunës së Gjilanit („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 43/75), Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE DHE FORMIMIN E PARALELEVE NË QENDRËN E PËRBASHKËT TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT TË MESËM TË ORIENTUAR NË GJILAN, PËR VITIN SHKOLLOR 1985/86

Neni 1

Në Qendrën e përbashkët të arsimit dhe edukimit të mesëm të orientuar në Gjilan, në vitin e parë të fazës së parë dhe në vitin e parë të fazës së dytë (vitin e tretë) në vitin shkollor 1985/86, nxënësit regjistrohen, si vijon:

1. Në vitin e parë të arsimit të përgjithshëm, në dy OTHPB me mësim në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke, regjistrohen 1781 nxënës.

2. Në vitin e parë (viti i tretë) të fazës së dytë në dy OTHPB në tri gjuhët mësimore, regjistrohen 1445 nxënës.

Neni 2

Në vitin e dytë të fazës së parë dhe në vitin e dytë (vitin e katërt) të fazës së dytë, regjistrohen të gjithë nxënësit që me sukses e kanë mbaruar vitin paraprak shkollor 1984/85.

Neni 3

Në fazën e dytë të arsimit dhe edukimit të mesëm të orientuar, sipas kërkesës dhe nevojave të OTHPB të ekonomisë dhe veprimtarive shoqërore, në Qendrën e mësipërme, në vitin shkollor 1985/86, nxënësit regjistrohen në 14 degë dhe 21 profesione, e që janë paraqitur dhe pasqyruar në pasqyret vijuese tabelare.

**OBPB-II E DEGEVE DHE PROFESIONEVE TEK-
NIKE „DRAGI POPOVIQ” NË GJILAN**

Degët	Profesionet	Shqip.	Serb.	Turq.	Gjithsejt	Shkalla e përgaditjes prof.
1. Bujqësi	— teknik i bujqësisë — tek. i pemëtarisë	35 35	35 —	— —	70 35	IV IV
2. Makinerisë	— tek. kontrollor — tek. tornitor — elektro salldues — salldues me gas	35 35 35 35	35 — — —	— — — —	70 35 35 35	IV IV III III
3. Eelektroteknike	— elektroteknik i automatikës — elektroteknik i rep-arteve motorike	70 35	35 —	— —	105 35	IV IV
4. Ndërtimtari	— teknik i ndërtim.	35	—	—	35	IV
5. Kimiko-teknologji	— teknik i degës kimiko-teknologjike	70	35	—	105	IV
6. Tekstilit	— konfeksionar — Endës	35 70	35 —	— —	70 70	III III
GJITHSEJT:	13	525	175	—	700	—

**OBPB III E DEGEVE DHE PROFESIONEVE EKONOMIKE-SHOQËRORE DHE NATYRORE-SHKENC-
ORE „ZENEL HAJDINI” NË GJILAN**

1. Ekonomike	— teknik kontabil. — tek. komerciale	70 35	35 —	— —	105 35	IV IV
2. Juridik biroteknike	— teknik për punë administrative	70	35	—	105	IV
3. Natyr-shkenc.	— labor. tek. për biol.	105	35	—	140	IV
4. Matem-teknik	— bashk. tek. i matem.	70	35	—	105	IV
5. Hoteleri	— Kuzhinier	35	35	—	70	III
6. Arsimore	— Drejtimi pedagogj.	105	35	—	140	IV
7. Shëndetësore	— tek. medicinal i drejtim. të përgj.	—	—	5	5	IV
8. Tregtisë	— shitës i mall. të përzier	35	—	—	35	III
GJITHSEJT:	9	525	210	5	740	—

Neni 4

Nxënësit dhe paralelet e fazës së parë dhe të dytë të arsimit dhe edukimit të mesëm të orientuar edhe në vitin shkollor 1985/86 do të punojnë në lokalet e tanishme të Qendrës së përbashkët për arsimimin dhe edukimin e mesëm të orientuar në Gjilan, ndërsa ca nga paralelet e fazës së parë edhe më tej do të punojnë në këto qendra fshatare: Bresalc dhe Përlepnice, ndërsa paralelet e kësaj Qendre nga Zhegra dhe Pogradja do të tërhiqen në qytet, kur të krijohen kushtet e lokalit dhe kushtet e tjera.

Neni 5

Në OBPB I të bazave unike në vitin shkollor 1985/86, themelohen tri paralele vijuesish për arsimimin dhe edukimin e mesëm të të rriturve, dy paralele në mësim në gjuhën shqipe dhe një paralele në mësim në gjuhën serbokroate.

Neni 6

Në OBPB II „Dragi Popoviq” dhe në OBPB III „Zenel Hajdini” në fazën e dytë, në vitin shkollor 1985/86 do të organizohet mësimi për fitimin e shkallës së parë, të dytë, të tretë, të katërt të aftësimit profesional, sipas kërkesave të punës së bashkuar dhe qytetarëve të interesuar, duke formuar paralele për vijues.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

01. Nr. 610-2/85
Gjilan 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabiye Hasani, d.v.

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Në bazë të nenit 4 dhe 7 të Ligjit mbi veprimtarinë komunale („Gazeta zyrtare e KSAK” nr. 30/76) dhe të nenit 252 të Statutit të komunës së Gjilanit, Kuvendi i komunës së Gjilanit, në mbledhjen e Dhomës së Punës së Bashkuar të Dhomës së Bashkësive Lokale në fushëveprim të barabartë, të mbajtur më 11 qershor 1985, mori

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI MIRËMBAJTJEN, SHFRYTËZIMIN DHE MBROJTJEN E OBJEKTEVE KOMUNALE-BANESORE TË QYTETIT TË GJILANIT

Neni 1

Në Vendimin mbi mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e objekteve komunale-banesore të qytetit të Gjilanit („Gazeta zyrtare e KSAK” nr. 17/81), pas nenit 13 shtohet neni i ri 13a i cili thotë:

„Objektet investuese të cilat janë ndërtuar pa lejen ndërtimore e që përputhen me Planin detaj urbanistik të qytetit të Gjilanit, mund të kyqen në rrjetin primar të ujësjellësit, kanalizimit dhe në rrjetin tjetër, me kusht që pronarët reciprokisht të marrin

pjesë në financimin e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit e të rrjetit të ngjashëm, me shumën e përcaktuar me programet e rregullimit të tokës së qytetit të Gjilanit, pjesa për ujësjellës, kanalizim e të ngjajshme, për çka do të nënshkruhet kontrata e posaçme për rregullim me Bashkësinë Vetëqeverisëse të Interesit për Banim dhe Veprimtari Komunale të Komunës së Gjilanit”.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të KSAK”.

01. Nr. 352-18/85
Gjilan, 11 qershor 1985

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Kryetari i Kuvendit
Fahredin Bexheti, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Punës së Bashkuar
Rabije Hasani, d.v.

Kryetari i Dhomës
së Bashkësive Lokale
Xhelal Mustafa, d.v.

PËRMBAJTJA

Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Ligji mbi formimin e Qendrës Krahinore për stërvitje të kuadrave për mbrojtjen e përgjithshme popullore . . .	623
Ligji mbi elektroekonominë . . .	625
Vendimi për shkarkimin e një anëtarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës	
Vendimi për shkarkimin e sekretarit krahinor të mbrojtjes popullore	632
Vendimi për zgjedhjen e një gjyqtari të Gjykatës Supreme të Kosovës	632
Vendimi për emërimin e zëvendësprokurorit publik krahinor në Prishtinë	633
Vendimi për shkarkimin dhe emërimin e zëvendësprokurorit publik të qarkut Prishtinë	633
Vendimi për shkarkimin dhe emërimin e kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan	633
Vendimi për emërimin e zëvendëskryetarit të Komitetit Krahinor të Arsimit, të Shkencës e të Kulturës	633
Vendimi për shkarkimin dhe emërimin e zëvendësavokatit krahinor shoqëror të vetëqeverisjes	634
Vendimi për pushimin e mandatit të delegatit në Dhomën e Komunave të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës	634
Vendimi për delegimin e një anëtarit në Tubimin e punëtorëve të Muzeut të Kosovës në përbërje të gjerë . . .	634

Sekretarijati Krahinor i Juftikaturës

Aktiviteti për formimin e Komisionit për lirin me kusht . . .	634
---	-----

Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Vendimi për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe të ligjshmërisë të Rregullorës të Bashkësisë Punuese të Komitetit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në Prishtinë mbi dhënie e banesave në shfrytëzim dhe ndarjen e kredive për ndërtimin individual banesor . . .	635
Vendimi për vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe të ligjshmërisë së Urdhës shoqërore për realizimin e politikës kadrovike në KSA të Kosovës . . .	635

Kuvendi i Komunës së Gjilanit

Vendimi për Buxhetin e komunës së Gjilanit për vitin 1985	636
Vendimi për aprovimin e Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të komunës së Gjilanit për vitin 1984 . . .	638
Vendimi për aprovimin e Llogarisë përfundimtare të tatimeve dhe të kontributeve të qytetarëve për vitin 1984 . . .	638
Vendimi për shitjen e lokaleve të punës, objekteve banesore dhe të tokës ndërtimore pronë e Kuvendit të Komunës së Gjilanit . . .	639
Vendimi për lirin nga llogaritja dhe pagesa e tatimit nga të ardhura personale të punëtorëve në organizatat e punës së bashkuar	640
Vendimi për përcaktimin e vendbanimeve në të cilat mund të ushtrohet shitja e gazetave nepërmas punëtorëve të pranuar në punë me kontratë për vitin 1985 . . .	640
Vendimi për regjistrimin e nxënësve dhe formimin e paraleleve në Qendrën e përbashkët të arsimit dhe edukimit të mesëm të orientuar në Gjilan për vitin shkollor 1985/86 . . .	640
Vendimi për plotësimin e Vendimit mbi mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e objekteve komunale-banesore të qytetit të Gjilanit . . .	642

Boton: Organizata gazetareske „Gazeta zyrtare e KSAK” — Prishtinë, rruga APJ 2, F. P. 182. Telefonat: drejtori 32-976, administrata dhe kontabiliteti 32-981. Drejtor dhe redaktor përgjigjës Alush Sallihu. Parapagimi për vitin 1985 është 1.600,00 di narë. Xhirrollogaria 68400—603—1221 SHKSH — Filiali në Prishtinë